



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P 277/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 30.07.2020 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Modifikimi i dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me Nr.REF-59423-05-29-2020 me objekt “*Ndertim Rruga Porto Romano Durrës, Loti 3*”, me fond limit 669.384.858,33 leke pa tvsh, parashikuar për tu zhvilluar në datën 02.07.2020 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Ankimues: “Geci” shpk
Tirana International Hotel, Sheshi Skënderbej, Nr.8
Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Autoriteti Rrugor Shqiptar
Rruga “Sami Frashëri” nr.33”, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.914 datë 29.12.2014 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” .

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik, konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 01.06.2020 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me Nr.REF-59423-05-29-2020 me objekt “*Ndërtim Rruga Porto Romano Durrës, Loti 3*”, me fond limit 669.384.858,33 leke pa tvsh, parashikuar për tu zhvilluar në datën 02.07.2020 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

II.2. Në datën 05.06.2020 operatori ekonomik “Geci” shpk, ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit me argumentat si më poshtë:

- Në datën 24.04.2020 ora 08:00 është publikuar nga autoriteti juaj kontraktor procedura e prokurimit me objekt *Ndërtim Rruga Porto Romano Durrës Loti 3*. Ndërkohë që nga ana jonë po studjoheshin kriteret për kualifikim dhe dokumentacioni i kërkuar konstatojmë që kjo procedurë prokurimi ishte anuluar nga AK me argumentin “*për shkaqe që dalin jashtë kontrollit të autoritetit kontraktor dhe të paparashikueshme në kohën e fillimit të procedurës së prokurimit duke respektuar*

parimet e barazisë dhe transparencës sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik.

- *Nga ripublikimi i saj në datë 07.05.2020 ora 08:00 konstatojmë se arsyeja e anullimit wshte pikërisht shkelja e kryer nga AK në lidhje me kriteret e përzgjedhjes së fituesit duke përcaktuar ofertën ekonomikisht më e favorshme në kundërshtim të hapur dhe flagrant me LPP dhe rregullat e prokurimit publik . Kjo përzgjedhje nuk mund të jetë kurësesi shkak që del jashtë kontrollit të AK dhe të paparashikueshme në kohën e fillimit të procedurës së prokurimit, përkundrazi është shumë e parashikueshme dhe është vënë me vetëdije të plotë. Si rrjedhim ose kriteri është vënë në kundërshtim me ligjin dhe zyrtarët përkatës duhet të mbajnë përgjegjësi ose anullimi rezulton të jetë bërë në kundërshtim me ligjin sic edhe e cituam më sipër dhe ngarkon me përgjegjësi ligjore AK-në.*
- *Referuar DT rezultonte që procedura e prokurimit do të zhvillohej më datë 10.06.2020 ora 11:00 por pikërisht thuhet një javë përpara datës së zhvillimit të procedurës konstatojmë se ajo është anuluar përsëri me pretendimin “AK ka konstatuar mospërputhje të projektit me specifikimet teknike dhe preventivin e punimeve autoriteti do të vijojë me rishikim të projektit. Edhe sikur ky argument të jetë i saktë përsëri anullimi është në kundërshtim me LPP ,nenin 24 i tij i cili përcakton saktësisht rastet kur mund të anulohet një procedurë prokurimi. Pasaktësitë në elementët e dokumentave standarte si projekt, specifikime teknike, dhe preventiv të punimeve janë përgjigjësi e AK. Në asnjë rast nuk mund të iniciohet një procedurë prokurimi nëse AK nuk ka pasur këto pjesë të DT të plota dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.*
- *AK në anullimin e mësipërm ka përcaktuar se AK do të vijojë me rishikimin e projektit ndërkohë që po atë ditë është ripublikuar procedura e prokurimit me të njëjtin projekt specifikime teknike dhe një sqarim “Mbi procedurën e tenderit të objektit Ndërtim Rruga Porto Romano loti 3.*
- *Si fillim ju bëjmë me dije që nuk është KVO autoriteti që duhet të sqarojë operatorët ekonomikë pjesmarrës në procedurë prokurimi. Deturat e KVO së janë përcaktuar saktësisht në rregullat e prokurimit publik dhe në dijeninë tonë kjo kompetencë nuk gjendet aty.*
- *Së dyti në dokumentat e ripublikuara nuk konstatojmë asnjë dokument pjesë e projektit të ndryshuar si shkak i rishikimit të kryer nga ana juaj përvec sqarimit të sipërcituar. Edhe sikur të kishte ndonjë ndryshim legjislacioni për prokurimin publik e ka fare të qartë si veprohet atë më tepër kur kemi të bëjmë vetëm me një sqarim. Në rastin e ndryshimit të DT përfshirë këtu edhe kriteret për kualifikim mbështetur në përcaktimet e nenit 42 të LPP autoriteti kontraktor nuk duhet të anulohet procedurën por mund të bëjë ndryshime përmes hartimit të një shtojce e cila ju vihet në dispozicion operatorëve ekonomikë në dokumentat standarte të tenderit të publikuara në SPE.*
- *Në datën 01.06.2020 ora 08:00 është publikuar për të tretën herë nga autoriteti juaj kontraktor procedura e prokurimit me objekt Ndërtim Rruga Porto Romano Durrës Loti 3 me fond limit 669,384,858.33 lekë pa tvsh.*

- *Pasi lexuam me kujdes të gjithë dokumentacionin e ngarkuar nga ana juaj konstatojmë se dy anulimet e bëra nuk lidhen me për shkaqe që dalin jashtë kontrollit të AK dhe të paparashikueshme në kohën e fillimit të procedurës së prokurimit as me mospërputhje të projektit me specifikimet teknike dhe preventivin e punimeve , autoriteti do të vijojë me rishikim të projektit por pikërisht me tendativa për të vjedhë fondet buxhetore nëpërmjet shkeljes së barazisë në tender dhe shpalljes së fituesve të paracaktuar.*
- *Pa ndryshuar asgjë nga projekti i veprës, specifikimet teknike, afati i realizimit të saj, preventivit të punimeve janë ndryshuar kriteret për kualifikim duke i përcaktuar ato në kundërshtim të hapur me legjislacionin në fuqi, por sigurisht që do të shërbejnë fituesit të paracaktuar. Duke pasur në konsideratë që në zbatim të nenit 61 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 i ndryshuar cdo kriter i vecantë dhe specifikim teknik duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht me të drejtë pyesim si është e mundur që keni pasur mundësi të argumentoni kriteret të ndryshme tre herë radhazi për të njëjtën procedurë.*
- *Sipas termave të referencës pjesë e DT rezulton që kemi të bëjmë me një kontratë shërbimi kjo bazuar në nenin 28 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 i ndryshuar ndërsa dokumentat e tenderit janë ndërtuar bazuar në nenin 26 Kontratat për punë publike të VKM -së mësipërme. Kjo është një kontratë shërbimi apo pune në bazë të së cilës bëhen dhe kërkesat për kualifikim pasi referuar dispozitave ligjore të prokurimit publik janë të ndryshme.*
- *Në pikën 2.2.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim nga administratori i subjektit si dhe vërtetim të lëshuar nga cdo njësi vendore për të dëshmuar se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitetet për vitet 2018.*
Së pari lidhur me kërkesën për vërtetimin të lëshuar nga cdo njësi vendore për të dëshmuar se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore në vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitetet për vitin 2018 është i pasaktë , i paligjshëm dhe jokorrekt. Nuk mund të kërkohet një kriter me një afat mbi 1 vit e 6 muaj nga data e zhvillimit të tenderit për të vërtetuar që ai është i rregullt me detyrimet e taksave vendore.
Së dyti në hartimin e DT AK duhet të referohet dokumentave standarte të miratuara me Vendimin Nr.6 datë 20.06.2019 të APP. Për rrjedhim AK nuk duhet të përfshijë këtë pikë të lista e deklaratave dhe shtojcave që duhet të dorëzojnë ofertuesit.
- *Në pikën 2.3.1.b 2.3.1.b Në rastin e përvijës së ngjashme në sektorin privat kërkohet si dëshmi formularët e vlerësimit sipas shtojcës përkatëse të DST të shoqëruar me kontratë të nënshkruara nga palet, Leje ndertimi, situacionet perfundimtare, faturat tatimore, akt kolaudimi të objektit,*

Formulari i vlerësimit është një dokument që lëshohet vetëm nga autoritetet kontraktore dhe jo nga subjektet private. Kjo është e mirëpërcaktuar dhe në shtojcën përkatëse ku cilësohet firma dhe vula e autoritetit kontraktor.

Gjithashtu duke marrë shkas nga fakti se Akti i Kolaudimit është një dokument që vërteton realizimin e punës në përputhje me lejen e ndërtimit, kërkesa për paraqitjen e lejes së ndërtimit është e panevojshme dhe nuk i shërben AK për të vërtetuar përmbushjen e sukseshme të punëve. Ky kriter është në kundërshtim me parashikimet e pikës 6 të nenit 26 të VKM nr.914 datë 29.12.2014.

- *Në pikën 2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të ketë një punësim mesatar, me jo më pak se 200 punonjës, për periudhën (Dhjetor 2019 – Maj 2020), e vërtetuar kjo me: Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për periudhën e kërkuar, shoqëruar me formularët E-SIG të konfirmuara nga organet përkatëse (me nënshkrim elektronik ose në hard copy).*

Kërkesa për një punësim mesatar me jo më pak se 200 punonjës është e ekzagjeruar duke pasur në konsideratë grafikun e punimeve dhe zërat e punës kjo nuk i shërben AK për të gjykuar atë çka është më e rëndësishme, kapacitetin që OE ofertues ka për të ekzekutuar kontratën që prokurohet.

Po kështu nisur nga data e zhvillimit të tenderit dhe pagesat e sigurimeve shoqërore që bëhet çdo tre muaj duhet që AK të zhvendosë periudhën kohore për listpagesat (duke mos e zgjatur si periudhë) për të marrë një informacion sa më real në lidhje me kriterin.

- *Në pikën 2.3.3 është kërkuar Operatori Ekonomik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, duhet të ketë në Stafit teknik kryesor të inxhinierëve minimalisht,*
- *1 (nje) Inxhinier Ndertimi/ profili Strukturist*
- *2 (dy) Inxhinier Ndertimi/profili transport;*
- *1 (nje) Inxhinier Ndertimi/profili Gjeoteknik;*
- *1(nje) Inxhinier Hidroteknik*
- *1 (nje) Inxhinier Mekanik*
- *3(tre) Inxhinier Topograf*
- *2 (dy) Inxhinier Elektrik*
- *1 (nje) Inxhinier Gjeolog*
- *1 (nje) Inxhinier mjedisi*

Për sejcilin pjestar te stafit teknik te mesiperm duhet te paraqese, Kontrate pune e vlefshme, diplome Libreze pune dhe CV, si dhe te rezultojne te siguruar ne listpagesat e shoqerise per periudhen Dhjetor 2019 – Maj 2020.

Ky kriter është në kundërshtim të hapur me rregullat e prokurimit publik që nuk është në përpjestim me punimet objekt i kësaj kontrate. Kështu edhe pse nuk është ndryshuar asgjë në projekt dhe specifikimet teknike të procedurës së anuluar në procedurën e re është shtuar kriteri për 1 Inxhinier Ndërtimi profili Strukturist dhe 1 Inxhinier Ndërtimi profili Gjeoteknik. Bazuar në tipologjinë e kontratës, në zërat e punimeve të përfshira në preventiv si dhe bazuar në stafin e parashikuar në relacionin teknik rezulton se AK nuk ka parashikuar punime për zbatimin e të cilave do të konsiderohej e pamjaftueshme ekspertiza profesionale e 1 Inxhinieri Ndërtimi profili Gjeoteknikë.

Ju bëjmë me dije se në bazë të preventivit për këtë procedurë prokurimi nuk ka asnjë zë punimesh që të korenspondojnë me profilin e inxhinier ndërtimi gjeoteknik. Në preventivin pjesë e dokumentave të tenderit ka punime që realizohen me inxhinier ndërtimi ose gjeolog pa qenë e nevojshme për inxhinier gjeoteknik. Ju sqarojmë se inxhinieria e gjeoteknikës është master 2 vjecar (i cili është futur vitet e fundit te fakulteti i inxhinierisë së ndërtimit) dhe ka në programin e vet këto punime (strukturat mbajtëse të dheut dhe mbrojtëse , të gjitha llojet e themeleve, me pilota, pllakë, tip plint, në tokë dhe në det, tunele , ura diga, laborator, gjeomekanike , përmirësim tunele, ura , diga, laborator , gjeomekanike , përmirësim bazamentesh, metro etj). Po të shikojmë preventivin e hedhur për zbatim nga ana juaj do të konstatatojmë që nuk ka asnjë lloj punimesh për inxhinier gjeoteknik prandaj edhe kërkesa e përcaktuar në kriteret e vecanta për kualifikim një inxhinier gjeoteknik , inxhinier ndërtimi profili gjeoteknikë është e paligjshme dhe në kundërshtim me LPP dhe RrPP.

Jo vetëm kaq por edhe detyrimi që ky inxhinier (si dhe të tjerët) të rezultojnë të siguruar në listpagesat e shoqërisë për periudhën Dhjetor 2019-Maj 2020 që ska të bëjë fare me realizimin e një veprë në të ardhmen është kriter që plotësohet vetëm nga fituesi i paracaktuar.

Së fundmi ndryshimi i kriterëve për të njëjtën procedurë pa asnjë arësye nga i njëjti autoritet kontraktor është dyshim i arsyeshëm për shkelje të barazisë në tender.

- *Në pikën 2.3.5 është kërkuar Operatoret ekonomike duhet te disponojne licensat e nevojshme per zbatimin e kontrates. Per kete duhet te paraqesin licensen perkatese te shoqerise, bazuar ne formatin e miratuar me Vendim te Keshillit te Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, "Per miratimin e rregullores per kriteret dhe Procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi". Shqyrtimi i licencave do te behet mbi bazen e rregullave te parashikuara sa me siper. Licensa profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e puneve te kontrates duhet te permbaje kategorite e meposhtme:*

- NP – 1/D (Punime germimi ne toke.)
- NP – 4/F (Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.)
- NP – 5/C (Punime nentokesore, ura e vepra arti.)
- NP – 7/C (Ujësjiellësa, gazsjellësa, vajsjiellësa, vepra kullimi e vaditje.)
- NP – 11/C (Ndërtime për N/Stacionet, kabinat e transformatoreve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarje e energjisë.)
- NP – 12/C (Punime të inxhinierisë së mjedisit.)
- NS – 6/C (Sinjalistikë rrugore jondriçuese)
- NS – 7/B (Bariera dhe mbrojtje rrugore)
- NS -18/ A (Punime topogjeodezike)

Referuar këtij preventivi referues konstatojmë që kategoritë e licencave që duhet të disponojnë operatorët ekonomikë me qëllim kualifikimi janë tërësisht të fryra që tejkalojnë nivelin e punëve të kërkuara për këtë procedurë prokurimi duke pasur në konsideratë fondin limit në dizpocion. Rezulton që nga ana juaj është kërkuar:

- NP – 1/D (Punime germimi ne toke. 101-200 milion lekë
- NP – 4/F (Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale. 401-800 milion lekë
- NP – 5/C (Punime nentokesore, ura e vepra arti. 51-101 milion lekë
- NP – 7/C (Ujësjiellësa, gazsjellësa, vajsjiellësa, vepra kullimi e vaditje.) 51-100 milion lekë
- NP – 11/C (Ndërtime për N/Stacionet, kabinat e transformatoreve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarje e energjisë.) 51-100 milion lekë
- NP – 12/C (Punime të inxhinierisë së mjedisit.) 51-100 milion lekë
- NS – 6/C (Sinjalistikë rrugore jondriçuese) 51-100 milion lekë
- NS – 7/B (Bariera dhe mbrojtje rrugore) 21-50 milion lekë
- NS -18/ A (Punime topogjeodezike) 0-20 milion lekë
- Si fillim konstatojmë që në mënyrë të paligjshme pa asnjë argument shtesë, projekt ose specifikim teknik është shtuar kategoria NS-7/B (Bariera dhe mbrojtje rrugore) edhe pse nga vetë AK është pranuar që nuk do të ketë sinjalistikë për këtë objekt në këtë fazë. Nëse marrim në konsideratë fondin limit të dhënë dhe vlerat minimale të licencave të kërkuara rezulton që tejkalojnë disa herë vlerën e punimeve që kërkohet. Bazuar në informacionin që disponojmë për projekte të tilla dhe Vendimin e KM nr.42 datë 16.01.2008 konstatojmë që shumë nga këto kategori nuk janë në përputhje me të.
- NP-7/C (Ujësjiellësa, gazsjellësa, vajsjiellësa, vepra kullimi e vaditje) 51-100 milion lekë. Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshme për realizimin “e shërbimit hidrik kompleks” ose për transportimin në vendet e përdorimit të gazrave, vajrave dhe veprave lidhëse, plotësuese ose ndihmëse edhe në pika të veçanta si edhe në të gjitha impiantet mekanik të nevojshme për të pasur një shërbim të mirë të nevojshëm gjatë përdorimit, funksionimit, informimit, sigurisë dhe asistencës për një funksionim normal. Përfshin në mënyrë të

thjeshtuar veprat e kaptazhit të ujit, impiantet e trajtimit të ujit të pijshëm, ujësjellësit, kullat e ujit, stacionet e pompimit, depozitat në tokë ose të ngritura, rrjetin shpërndarës deri tek përdoruesi, furnizimi dhe vendosja në vepër e tubacioneve, shkarkimet e ujërave të zeza, si dhe trajtimin e ujërave të përdorura.

Ky kriter nuk ka asnjë bazë ligjore në lidhje me objektin e prokurimit. Referuar preventivit të dhënë për këtë kategori punimesh ka zero punime. Kriteri qëllimisht do të sjellë kufizimin e pjesmarrjes së OE ofertues të mundshëm të cilët vlerësohet se kanë kapacitetin e nevojshëm dhe të mjaftueshme për ekzekutimin e kontratës, AK duhet ti përmbahet edhe përcaktimeve të nenit 20 të LPP për të shmangur cdo kriter apo kërkesë që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre.

- *NP-12/C “Punime të inxhinierisë së mjedisit) 51-100 milion lekë Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimin të kompaktësimin të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik dhe zoologjik. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar procesin e riaftësimin natyror, botanik, faunistik, konservimin dhe riaftësimin e terrenit të përdorur për karriera e gurorë, dhe të baseneve hidrografike, eliminimin e prishjes së ekuilibrave hidrogeologjik nëpërmjet kthimit në toka buke të veprave për stabilizimin e shpatëve dhe ripyllëzimeve të punimeve të sistemit bujqësor dhe të veprave për rivegetizimin e skarpateve rrugore, hekurudhor të karriera dhe mbetjeve inerte.*

Ky kriter nuk ka asnjë bazë ligjore në lidhje me objektin e prokurimit aq më tepër në nivelin C. Ky kriter nuk ka asnjë bazë ligjore në lidhje me objektin e prokurimit.. Kriteri qëllimisht do të sjellë kufizimin e pjesmarrjes së OE ofertues të mundshëm të cilët vlerësohet se kanë kapacitetin e nevojshëm dhe të mjaftueshme për ekzekutimin e kontratës, AK duhet ti përmbahet edhe përcaktimeve të nenit 20 të LPP për të shmangur cdo kriter apo kërkesë që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre.

- *NS-6C (Sinjalistikë rrugore jo ndricuese) 51-100 milion lekë Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja, ristrukturimi dhe kryerja e sinjalistikës rrugore jondricuese, vertikale, horizontale dhe komplementare.*

Ky kriter nuk ka asnjë bazë ligjore në lidhje me objektin e prokurimit aq më tepër në nivelin C. Kriteri qëllimisht do të sjellë kufizimin e pjesmarrjes së OE ofertues të mundshëm të cilët vlerësohet se kanë kapacitetin e nevojshëm dhe të mjaftueshme për ekzekutimin e kontratës, AK duhet ti përmbahet edhe përcaktimeve të nenit 20 të LPP për të shmangur cdo kriter apo kërkesë që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre.

- Në pikën 2.3.6 është kërkuar: Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar si pjesë të stafit I (një) ekspert i pajisur me “Licence zbatimi për veprimtari Arkeologjike” (Me qëllim që të monitorohen punimet për të mos patur pasoja të mundshme në Arkeologji, shohim të arsyeshme që në përberje të stafit të jete edhe eksperti i mesiperm). Të paraqese, Kontrate pune e vlefshme, diplome , Libreze pune dhe CV, si dhe të rezultojnë të siguruar në listpagesat e shoqërisë për të paktën 6 (gjashtë) muajt e fundit.

Ky kriter është vënë në kundërshtim të hapur me rregullat e prokurimit publik , nuk është në përputhje me punimet objekt i kësaj kontrate. Kështu edhe pse nuk është ndryshuar asgjë në projekt dhe specifikimet teknike të procedurës së anuluar në procedurën e re është shtuar kriteri Licence zbatimi për veprimtari Arkeologjike”. Sipas VKM përkatëse “Cdo individ apo person juridik që kërkon të ushtrojë veprimtari në fushën e arkeologjisë duhet të pajisjet me licencë profesionale përkatëse bazuar në kushtet e parashikuara në këtë vendim. Nuk e kuptojmë nëse AK në këtë rast po kërkon për thesare apo po ndërton një rrugë në gjurmën ekzistuese të saj . Jo vetëm kaq por kërkohet që të jetë pjesë e OE duke qenë i siguriar 6 muaj përpara zhvillimit të tenderit. Kuptohet qartë që është kriter që e ka vetëm subjekti i paracaltuar fitues nga ana juaj. Në studimin që iu bë nga ana jonë dokumentacionit të paraqitur por edhe vendodhjes së objektit konstatojmë që:

Objekti nuk është në zonën e mbrojtur

Është rrugë ekzistuese

Në të gjitha specifikimet teknike nuk gjen asnjë fjalë të vetme që të trajtojë arkeologjinë. Në informacionin e publikuar nga AK thuhet shprehimisht “Projekti shtrihet në zonën ish kënetë të Durrësit dhe shërben kryesisht si rrugë për zhvillimet dhe planifikimet në fushën e industrisë së naftës. Projekti shtrihet në një zonë ku momentalisht ka mjaft probleme mjedisore me ndotjen dhe depozitimin e plehrave të cilat kanë kontaminuar të gjithë zonën dhe përbëjnë shqetësim real për banorët dhe biznesin.

- *Ky kriter nuk ka asnjë bazë ligjore në lidhje me objektin e prokurimit dhe qëllimisht do të sjellë kufizimin e pjesëmarrjes së OE ofertues të mundshëm të cilët vlerësohet se kanë kapacitetin e nevojshëm dhe të mjaftueshme për ekzekutimin e kontratës, AK duhet ti përmbahet edhe përcaktimeve të nenit 20 të LPP për të shmangur cdo kriter apo kërkesë që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre.*

- Në pikën 2.3.7 është kërkuar: Operatori ekonomik duhet të disponojë dhe paraqese leje dhe licensa si me poshte:

- *License për grumbullimin dhe transportimin, e mbetjeve urbane që kanë ndikim në mjedis,* Kodi III.2.B të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit

- *Licence III.2.A (1+2) - Veprimtarite e Vleresimit të Ndikimit në Mjedis*

- *Licence III.1.A tipi C - “Për trajtimin/magazininin e mbetjeve të tjera të ujërave të zeza urbane, duke përfshirë llumin nga ujrat e ndotura urbane, llumin e çisternave septike,*

mbetjet e ujrave te zeza nga gropa te hapura, mbetje nga pastrami I kanaleve te ujrave te zeza”

Së pari në vendosjen e kriterit për disponimin e licencës Kodi III.2.A (1+2) AK në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik dhe ligjit rregullues nuk ka zbatuar detyrimet e përcaktimeve të nenit 46 të LPP ku përcakton se cdo kriter i vecantë duhet të jetë në përputhje dhe i lidhur ngushtë me natyrën e kontratës e për rrjedhim kërkesa për licensat e sipërcituara duhet të përkojë me tipologjinë e objektit të kontratës që prokurohet.

Po kështu në kuptimin e përcaktimit të pikës a të nneit 1 të Ligjit nr.10440 datë 07.07.2011 Për vlerësimin e ndikimit në mjedis sipas së cilës qëllimi i këtij ligji është të sigurojë një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit përmes parandalimit, minimizimit dhe kompesimit të dëmeve në mjedis nga projektet të propozuara që përpara miratimit të tyre për zhvillim për rrjedhim shërbimet e ekspertizës në fjalë janë realizuar në fazën e studimit dhe projektimit të objekteve ndërtimore.

Rezulton që ekspertizat profesionale në fjalë janë ezauruar në procesin e studimit dhe projektimit nëpërmjet hartimit të preventivit specifikimeve teknike, projektit, relacioneve teknike respektive.

Për rrjedhojë të sa më lart argumentohet që kërkesa në fjalë do të sjellë kufizimin e pjesmarrjes së OE ofertues të mundshëm të cilët konsiderohen që disponojnë kapacitetet e nevojshme dhe të mjaftueshme për zbatimin e kontratës. Në këtë mënyrë janë cënuar parashikimet e nenit 20 të LPP që cdo kërkesë apo kriter që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre ose paracaktim të fituesve.

- *Së dyti Licencë III.1.A tipi C Per trajtimin/magazinimin e mbetjeve te tjera te ujrave te zeza urbane, duke perfshire llumin nga ujrat e ndotura urbane, llumin e çisternave septike, mbetjet e ujrave te zeza nga gropa te hapura, mbetje nga pastrami I kanaleve te ujrave te zeza”*

Ky kriter është vënë në kundërshtim të hapur me rregullat e prokurimit publik , nuk është në përputhje dhe me punimet objekt i kësaj kontrate. Kështu edhe pse nuk është ndryshuar asgjë në projekt dhe specifikimet teknike të procedurës së anuluar në procedurën e re është shtuar kriteri i mësipërm i cili nuk ka lidhje me realizimin e objektit të kontratës.

Referuar projektit , specifikimeve teknike, dhe zërave të preventivit nuk rezulton asnjë detaj i kontratës që lidhet me trajtimin, magazinimin e mbetjeve të tjera të ujrave të zeza urbane duke përfshirë llumin dhe ujrat e ndotura urbane , llumin e çisternave septike, mbetjet e ujrave te zeza nga gropa te hapura, mbetje nga pastrami i kanaleve

te ujrave te zeza. AK qëllimisht ka ngatëruar ndërtimin e rrugës me pastrimin e gropave septike por është akoma më e rëndë kur nga ana tjetër kërkohet arkeolog.

Autoriteti kontraktor nuk mund të kërkojë leje mjedisore për cdo zë të preventivit (edhe pse nuk ka të tillë) të shërbimeve që kërkohen të realizohen por duhet të përcaktojë kriterin duke u bazuar në objektin e përgjithshëm të prokurimit. Për sa kohë që objekti i procedurës së mësipërme të prokurimit është pastrimi, grumbullimi dhe largimi i mbeturinave rrjedhimisht dhe kërkesa për leje mjedisore duhet të hartohet në përputhje me këtë objekt. Shkelje të tilla me dashje nuk janë vetëm shkelje administrative por penale që në rast mosrefektimi nga ana juaj do të përgjigjeni.

- Në pikën 2.3.13 është kërkuar:

Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Për këto duhet të paraqesë dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik.

Kërkohen të jenë në dispozicion këto mjete pune:

Nr	Emri i mjetit	Njesi	Sasi	Statusi
1	Kamiona vetshkarkues min 20 ton	Copë	25	Në pronësi ose me qera
2	Kamiona vetshkarkues 10 deri 18 ton	Copë	4	Në pronësi ose me qera
3	Kamioncine deri 4.5 ton	Copë	6	Në pronësi ose me qera
4	Ekskavatorë me zinxhire	Copë	8	Në pronësi ose me qera
5	Ekskavatorë me goma	Copë	4	Në pronësi ose me qera
6	Ekskavator me krahe te gjate mbi 15 m	Copë	1	Në pronësi ose me qera
7	Fadrome me goma	Copë	3	Në pronësi ose me qera
8	Minieskavatore	Copë	6	Në pronësi ose me qera
9	Çekiç për Eskavator	Copë	2	Në pronësi ose me qera
10	Autobot Uji	Copë	4	Në pronësi ose me qera
11	Buldozer (traktor) ≥ 80 HP	Copë	2	Në pronësi ose me qera
12	Autobetoniere	Copë	3	Në pronësi ose me qera
13	Autobitumatrice	Copë	1	Në pronësi ose me qera

14	Greider	Copë	2	Në pronësi ose me qera
15	Asfalto shtruese	Copë	2	Në pronësi ose me qera
16	Rrul me vibrim gome cylinder mbi 18 ton	Copë	2	Në pronësi ose me qera
17	Rrul cilindër – cilindër der 13 ton asfalti	Copë	2	Në pronësi ose me qera
18	Rul gome cilindër 15 ton	Copë	1	Në pronësi ose me qera
19	Rrul vibrus deri në 8 ton	Copë	4	Në pronësi ose me qera
20	Autovinç	Copë	2	Në pronësi ose me qera
21	Minifadrom	Copë	2	Në pronësi ose me qera
22	Depozitë Uji	Copë	2	Në pronësi ose me qera
23	Pompe uji	Copë	4	Në pronësi ose me qera
24	Sistem Ëell Point për heqjen e ujrave	Copë	4	Në pronësi ose me qera
25	Gjenerator	Copë	5	Në pronësi ose me qera
26	Batipal	Copë	1	Në pronësi ose me qera
27	Hydromulcher, me kapacitet minimum 4 ton	Copë	1	Në pronësi ose me qera
28	Makineri vijezimi	Copë	1	Në pronësi ose me qera
29	Vinç me kapacitet minimumi 20 ton	Copë	1	Në pronësi ose me qera
30	Vibrator	Copë	6	Në pronësi ose me qera
31	Nyje inerte e paisur leje mjedisore kodi III.1.B	Copë	1	Në pronësi ose me qera ose kontrate furnizimi
32	Fabrike asfalti e paisur leje mjedisore kodi III.1.B	Copë	1	Në pronësi ose me qera ose kontrate furnizimi
33	Fabrike prodhim betoni e paisur leje mjedisore kodi III.1.B	Copë	1	Në pronësi ose me qera ose kontrate furnizimi
34	Sonde (turjele) për shtyllat e betonit Ø 400mm	Copë	1	Në pronësi ose me qera
35	Tërheqës + gjysmë rimorkio	Copë	4	Në pronësi ose me qera

Së pari edhe pse nuk është ndryshuar asgjë në projekt dhe specifikimet teknike të procedurës së anuluar në procedurën e re janë shtuar kriteret për disponimin e kapaciteteve:

<i>Ekskavator me krahe te gjate mbi 15 m 1 copë</i>
<i>Buldozer (traktor) ≥ 80 HP 2 copë</i>
<i>Autobetoniere 1 copë</i>
<i>Rrul cilindër – cilindër der 13 ton asfalti copë 2</i>
<i>Sistem Ëell Point per heqjen e ujrave 4 copë</i>
<i>Gjenerator 3 copë</i>
<i>Hydromulcher, me kapacitet minimum 4 ton 1 copë</i>
<i>Vinç me kapacitet minimumi 20 ton 1 copë</i>
<i>Sonde (turjele) per shtyllat e betonit Ø 400mm 1 copë</i>
<i>Tërheqës + gjysmë rimorkio</i>

Ndërkohë janë hequr kriteret për disponimin e kapaciteteve

Rrul me goma asfalti mbi 25 ton copë

Motobetoniere 2 copë

Autobitumatrice 2 copë Greider 2 copë

Asfaltoshtruese 2 copë

Eskavatorë me goma 2 copë.

Së dyti referuar kriterëve të vecanta për kualifikim konstatohet se ndër të tjera autoriteti kontraktor ka parashikuar një listë të mjeteve dhe të pasjisjeve të cilat janë të nevojshme për realizimin e synimit parësor të autoritetit kontraktor të përmbushjes me sukses të kontratës objekt prokurimi. Ky qëllim i ligjit është shkelur tërësisht kur me një të hedhur të syrit konstatohet që kriteret ndryshohen sipas dëshirës së zyrtarëve të ngarkuar me qëllim zbatimin e tij. Për çfarë duhet një ekskavator me krahe të gjatë mbi 15 m që në procedurën e parë nuk qe e nevojshme?? Po kapaciteti Vinc me kapacitet minimumi 20 ton çfarë duhet të ngrejë ndërkohë që nuk ka ansjë peshë të tillë referuar preventivit të dhënë??? Po një rul cilindër cilëindër der 13 ton asfalti kur më parë ishte rrul cilindër cilindër 10-12 ton asfalti?? Çfarë e bëri njësinë e prokurimit të ndryshojë mendje kaq shpejt???

*Në kundërshtim me ligjin dhe RRPP rezulton që janë përcaktuar kamionet e tonazheve Kamiona vetshkarkues min 20 ton; Kamiona vetshkarkues 10-18 ton; kamioncinë deri 4.5 ton pa ansjë bazë ligjore. AK duhet të kërkojë kapacitete mbartëse me qëllim realizimin e kontratës pavarësisht llojit të kamionit duke e kufizuar atë vetëm nëse dëmton rrugën. Por vetë kriteri i dhënë prej 25 kamionësh mbi 20 ton përcalton që nuk ka qenë ky qëllimi. Kapaciteti i kërkuar prej 25*20 t baras 500 t plus 4x15 t baras 60 t plus 4.5x6 baras 27 t në total 587 ton mjete është tejet e ekzagjeruar. Ky kriter nuk ka asnjë bazë ligjore në lidhje me objektin e prokurimit. Kriteri qëllimisht do të sillte kufizimin e pjesmarrjes së OE ofertues të mundshëm të cilët vlerësohen se kanë kapacitetet e nevojshme dhe të mjaftushme për ekezekutimin e kontratës. PO kështu të gjitha kapacitetet në mjete duhet të rishikohen dhe të vihen në përputhje*

me objektin e kontratës dhe rregullat e prokurimit publik. Nuk mund të përcaktoni fituesin me cdo kusht. Jeni të detyruar të zbatoni dispozitat ligjore në fuqi.

- *Në pikën 2.3.15 Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikatat të vlefshme si me poshte:*
- *EN-ISO 14001:2004 (Sistemi i menaxhimit të mjedisit)*
- *EN- ISO 9001-2015 (Sistemi i menaxhimit të cilësisë)*
- *EN-OHSAS 18001:2007 (Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë)*
- *ISO 39001:2012 (Sistem i menaxhimit të sigurisë rrugore dhe trafikut)*

Për sa më sipër në lidhje me certifikatën EN OHSAS 18001:2007 duhet që AK të pranojë edhe OE të cilët disponojnë certifikatën me standartin e azhornuar dhe ekuivalent të njohur nga standartet shqiptare ISO 45001:2018.

II.3. Me shkresën nr.3914/2 prot datë 09.06.2020, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimesit ku ka vendosur pranimin e pjesërisht të ankesës.

II.4. Në datën 16.06.2020 pala ankimese “Geci” shpk., ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese drejtuar autoritetit kontraktor.

II.5. Nëpërmjet shkresës nr.4347/1 prot., datë 23.06.2019 protokolluar me tonën me nr.580/2 datë 30.06.2020 me objekt “*Dërgohet informacion*”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes “Geci” shpk se “*Sipas termave të referencës pjesë e DT rezulton që kemi të bëjmë me një kontratë shërbimi kjo bazuar në nenin 28 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 i ndryshuar ndërsa dokumentat e tenderit janë ndërtuar bazuar në nenin 26 Kontratat për punë publike të VKM -së mësipërme. Kjo është një kontratë shërbimi apo pune në bazë të së cilës bëhen dhe kërkesat për kualifikim pasi referuar dispozitave ligjore të prokurimit publik janë të ndryshme*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në nenin 3 pika 8 “Përkufizime” të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar parashikohet se: *“Kontratat për punë publike” janë kontratat publike, që kanë objekt realizimin, projektimin dhe realizimin e punimeve apo të punës ose realizimin me çfarëdo mjeti të një pune, që përputhet me kërkesat e përcaktura nga autoriteti kontraktor.*

III.1.2. Në nenin 26 “Kontarta për Punë Publike” të VKM nr.914 datë 29.12.2014 e ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

- *Specifikimet teknike shprehin qartë kërkesat e autoritetit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës.*
- *Autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit parashikon me grafik, fazat dhe afatet e realizimit të punëve.*
- *Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve*

III.1.3. Referuar sa më sipër KPP pas shqyrtimit në tërësi të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi e konkretisht kriterëve kualifikuese, preventivit të punimeve, relacioneve teknike, grafikut të punimeve gjykon se kjo kontratë përmbush të gjitha kushtet e një kontrate për punë publike sipas termave dhe përkufizimeve ligjore. Akoma më tej objekti i procedurës së prokurimit objekt ankimi flet qartë për natyrën e kontratës duke mos lënë vend për keqkuptim dhe konfuzion lidhur me natyrën e kontratës objekt prokurimi. Pretendimin e ankimuesit se kemi të bëjmë me një kontratë shërbimi referuar termave të referencës KPP e gjen tërësisht të pabazuar.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Geci” shpk për modifikimin e kriterit *“Në pikën 2.2.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim nga administratori i subjektit si dhe vërtetim të lëshuar nga cdo njësi vendore për të dëshmuar se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitet 2018.*

Së pari lidhur me kërkesën për vërtetimin të lëshuar nga cdo njësi vendore për të dëshmuar se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore në vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin 2018 është i pasaktë, i paligjshëm dhe jokorrekt. Nuk mund të kërkohet një kriter me një afat mbi 1 vit e 6 muaj nga data e zhvillimit të tenderit për të vërtetuar që ai është i regullt me detyrimet e taksave vendore.

Së dyti në hartimin e DT AK duhet të referohet dokumentave standarte të miratuara me Vendimin Nr.6 datë 20.06.2019 të APP. Për rrjedhim AK nuk duhet të përfshijë këtë pikë të

lista e deklaratave dhe shtojcave që duhet të dorëzojnë ofertuesit”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në shtojcën 12 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” pika 2.2.3 “Kapaciteti teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

2.2.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim nga administratori i subjektit si dhe vërtetim të lëshuar nga cdo njësi vendore për të dëshmuar se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitetet për vitet 2018

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetuesinë e informacionit të paraqitur. Në rast deklarimi të rreme do të vepohet në përputhje me nenin 13, pika 3, germa ”a” të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, “Per Prokurimin Publik”.

III.2.2. Referuar kthim përgjigjes së autoritetit kontraktor drejtuar ankimuesit lidhur me kriterin sa më lart sqarohet se: *Duke marrë shkas nga pretendimi i ankimuesit gjykojmë se në mënyrë që kriteri të bëhet koherent dhe i logjikshëm (pasi përvec 2020 që është në vijim dhe ka një situatë specifike emergjence të shkaktuar nga Covid 19 viti i fundit ushtrimor është 2019), Njësia e Prokurimit të reflektojë ndryshimin duke e saktësuar paragrafin si vijon: Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim nga administratori i subjektit si dhe vërtetim të lëshuar nga cdo njësi vendore për të dëshmuar se ka paguar të gjitha detyrimet taksave dhe tarifave vendore, në vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitetet për vitin 2019.*

III.2.3. Referuar sa më sipër KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka pranuar kërkesën e ankimuesit lidhur me kriterin mbi taksat vendore duke kërkuar kështu përvec deklaramit dhe vërtetimet përkatëse nga cdo njësi vendore që provon pagesën e tyre për vitin 2019, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Lidhur me pretendimin e ankimuesit për mospërfshirjen e kësaj pike në listën e deklaratave dhe shtojcave që duhet të dorëzojnë ankimeusit KPP gjykon se paraqitja e një deklaratë të thjeshtë nga ofertuesit se kanë paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, nuk shkakton asnjë vështirësi për operatorët ekonomikë ofertues, nuk është diskriminuese dhe nuk e pamundur për tu plotësuar .

Lidhur me kërkesën e pranuar nga autoriteti kontraktor, KPP nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike konstaton se autoriteti kontraktor nuk ka publikuar shtojcën me modifikimet përkatëse. Në këtë kuptim KPP gjykon se autoriteti kontraktor duhet të hartojë shtojcën me ndryshimet përkatëse dhe njëherazi të bëjë publikimin e saj në SPE në përputhje me nenin 42 të LPP i cili parashikon shprehimisht se: *Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar*

burimin e kërkesës, duhet t'ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”Autoriteti kontraktor, në çdo kohë, përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë për sqarim nga një operator ekonomik, mund të bëjë ndryshime në dokumentet e tenderit, përmes hartimit të një shtojce. Çdo shtojcë u komunikohet menjëherë të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit dhe bëhet detyruese për ta. Shtojca vihet në dispozicion edhe në rrugë elektronike.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Geci” shpk për modifikimin e kriterit Në pikën 2.3.1.b 2.3.1.b *Në rastin e përvjes se ngjashme ne sektorin privat kerkohet si deshmi formularet e vleresimit sipas shtojces perkatese te DST te shoqeruar me kontrate e nenshkruara nga palet, Leje ndertimi, situacionet perfundimtare, faturat tatimore, akt kolaudimi te objektit, Formulari i vleresimit është një dokument që lëshohet vetëm nga autoritetet kontraktore dhe jo nga subjektet private. Kjo është e mirëpërcaktuar dhe në shtojcën përkatëse ku cilësohet firma dhe vula e autoritetit kontraktor. Gjithashtu duke marrë shkas nga fakti se Akti i Kolaudimit është një dokument që vërteton realizmin e punës në përputhje me lejen e ndërtimit, kërkesa për paraqitjen e lejes së ndërtimit është e panevojshme dhe nuk i shërben AK për të vërtetuar përmbushjen e sukseshme të punëve. Ky kriter është në kundërshtim me parashikimet e pikës 6 të nenit 26 të VKM nr.914 datë 29.12.2014.*

III.3.1. Në shtojcën 12 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” pika 2.3.1 “Kapaciteti teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

2.3.1/a Operatori Ekonomik duhet te kete realizuar punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më pak se 50% e fondit limit dhe që është realizuar me sukses gjatë tri viteve të fundit;

2.3.1/b. ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku, gjatë tri viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i fondit limit dhe që është realizuar me sukses gjatë tri viteve të fundit.

Plotësimi i njërit prej 2 kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

2.3.1/a Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti Operatori Ekonomik duhet te paraqese formularet e vleresimit sipas shtojces perkatese te DST te shoqeruar me kontraten/kontratat e nenshkruara nga palet, situacionet perfundimtare, faturat tatimore, aktet e kolaudimit. Formulari i vleresimit duhet te percaktoje saktësisht cilësinë e kryerjes se punëve, dhe faktin nëse kontrata eshte realizuar me sukses.

2.3.1.b Në rastin e përvjes se ngjashme ne sektorin privat kerkohet si deshmi formularet e vleresimit sipas shtojces perkatese te DST te shoqeruar me kontrate e nenshkruara nga palet, Leje ndertimi, situacionet perfundimtare, faturat tatimore, akt kolaudimi te objektit.

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

III.3.2. Në nenin 46, pika 1, të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” parashikohet shprehimisht se: *"Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese."*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-se përcakohet se: *"Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit."*

III.3.3. Referuar VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 26 “Kontratat për punë publike”, pika 5 përcaktohet: *“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

III.3.4. Referuar Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 26 “Kontratat për punë publike”, pika 6 përcaktohet:

Për të provuar përvojën mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

- *Autoriteti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ku të shënohen vlera, koha dhe natyra e punës së bërë dhe çdolloj dokumenti tjetër, që parashikohet në legjislacionin në fuqi, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshmetë punëve.*
- *Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti kontraktor kërkon si dëshmi vërtetime ku të shënohen vlera, koha dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdolloj dokumenti tjetër, që parashikohet në legjislacionin në fuqi, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.*

III.3.5. Referuar bazës ligjore të sipërcituar, KPP vëren se rregullat e prokurimit publik parashikojnë shprehimisht dokumentacionin që duhet të kërkohe nga autoritetet kontraktore

dhe paraqitet nga ofertuesit lidhur me dëshminë për eksperience të ngjashme të kryer me sektorin privat e konkretisht Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti kontraktor kërkon si dëshmi vërtetime ku të shënohen vlera, koha dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdolloj dokumenti tjetër, që parashikohet në legjislacionin në fuqi, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit për heqjen nga kriteri i vecantë i kualifikimit të përcaktimit formular vlerësimi me argumentin se formulari i vlerësimit është një dokument që lëshohet vetëm nga autoritetet kontraktore dhe jo nga subjektet private, është i drejtë pasi formulari i vlerësimit sipas shtojcës përkatëse në DT të kërkuar nga autoriteti në rastin konkret, ka të bëjë me një dokument i cili është konceptuar për tu plotësuar nga autoritetet kontraktore. Në këtë kuptim KPP gjykon se autoriteti kontraktor duhet të riformulojë kriterin e vecantë të kualifikimit duke i qëndruar strikt përcaktimeve në nenin 26 pika 6 e VKM ku shprehimisht është parashikuar se në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti kontraktor kërkon si dëshmi vërtetime ku të shënohen vlera, koha dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdolloj dokumenti tjetër, që parashikohet në legjislacionin në fuqi, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Pra në vend të fjalës formular vlerësimi duhet të përdoret termi vërtetim i lëshuar nga subjektet private në mënyrë që të shmanget cdo lloj paqartësie dhe konfuzioni në rradhët e operatorëve ekonomikë gjatë përgatitjes së ofertës së tyre dhe gjithashtu edhe për të evituar cdo lloj vështirësie në punën e KVO gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit.

III.3.6. Ndërsa sa i takon pretendimit tjetër të ankimuesit lidhur me kriterin sa më sipër autoriteti kontraktor në kthim përgjigjen drejtuar ankimuesit sqaron si vijon: *Leja e ndërtimit përbën një dokument që në bazë të ligjit nr.8402 datë 10.09.1998 Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit dhe Udhëzimeve për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit të dala në zbatim të tij përbën pjesë të dosjes së kolaudimit dhe është dokument që lidhet plotësisht me procesin e kolaudimit të vepërës e si rrjedhojë edhe me formularin e vlerësimit të kërkuar i cili pjesë përbërëse të tij ka situacionin përfundimtar dhe aktin e kolaudimit.*

Në lidhje me kërkesën mbi dorëzimin e lejes së ndërtimit, KPP konstaton se në rregullat e prokurimit publik, në nenin 26 pika 6 të të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar është lënë në vlerësim/ diskrecionin e autoritetit kontraktor përcaktimi i çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet në legjislacionin në fuqi. Në nenin 8 të ligjit nr.8402 datë 10.09.1998 “ Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, parashikohet se: “ *Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas apo të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore.*” Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose europiane” .

Sa më sipër, KPP vlerëson se leja e ndërtimit përbën dokumentin bazë për nisjen e punimeve, dhe për rrjedhojë operatorët ekonomikë pjesëmarrës që disponojnë dëshmi të eksperiencës së ngjashme *ipso legge* disponojnë edhe aktin mbi miratimin e lejes së ndërtimit, për rrjedhojë KPP vlerëson se kërkesa e mësipërme është në përputhje me legjislacionin sektorial dhe nuk përbën kosto shtesë, barrierë apo diskriminim të cdo lloji natyre për operatorët ekonomikë pjesëmarrës.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues pjesërisht qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Geci” shpik për modifikimin e kriterit “Në pikën 2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të ketë një punësim mesatar, me jo më pak se 200 punonjës, për periudhën (Dhjetor 2019 – Maj 2020), e vërtetuar kjo me: *Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për periudhën e kerkuar, shoqeruar me formularët E-SIG të konfirmuara nga organet perkatese (me nenshkrim elektronik ose ne hard copy).*

Kërkesa për një punësim mesatar me jo më pak se 200 punonjës është e ekzagjeruar duke pasur në konsideratë grafikun e punimeve dhe zërat e punës kjo nuk i shërben AK për të gjykuar atë çka është më e rëndësishme, kapacitetin që OE ofertues ka për të ekzekutuar kontratën që prokurohet.

Po kështu nisur nga data e zhvillimit të tenderit dhe pagesat e sigurimeve shoqërore që bëhet cdo tre muaj duhet që AK të zhvendosë periudhën kohore për listpagesat (duke mos e zgjatur si periudhë) për të marrë një informacion sa më real në lidhje me kriterin”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.4.1. Në shtojcën 12 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” pika 2.3.2 “Kapaciteti teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

- *2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të ketë një punësim mesatar, me jo më pak se 200 punonjës, për periudhën (Dhjetor 2019 – Maj 2020), e vërtetuar kjo me: Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për periudhën e kerkuar, shoqeruar me formularët E-SIG të konfirmuara nga organet perkatese (me nenshkrim elektronik ose ne hard copy).*

III.4.2. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “*Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.*”

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “*Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit... .*”

III.4.3. Referuar Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se *“Kontratat për punë publike” janë kontratat publike, që kanë objekt realizimin, projektimin dhe realizimin e punimeve apo të punës ose realizimin me çfarëdo mjeti të një pune, që përputhet me kërkesat e përcaktura nga autoriteti kontraktor.*

III.4.4. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 26, pika 8, parashikohet si më poshtë:
Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratë”

III.4.5. Në interpretim literal të bazës ligjore të sipërcituar Komisioni vlereson se kriteret e kualifikimit duhet të jenë në përputhje me objektin e prokurimit, natyrën, aftësinë zbatuese, vlerën si dhe përmasat/volumin e kontratës. Referuar specifikimeve teknike si dhe kërkesave të autoritetit kontraktor në dokumentat e tenderit vërehet se ky i fundit kërkon të realizojë objektin *Ndërtim rruga Porto Romano Loti 3* për një periudhë 12 mujore.

Për realizimin me sukses të kësaj kontrate autoriteti kontraktor ka gjykuar si të nevojshme disponimin nga ana e operatoëve ekonomikë pjesmarrës të një numri të punësuarish prej 200 punonjësish.

Lidhur me këtë kërkesë KPP gjykon ti referohet kreut III të Vendimit nr, 42 datë 16.01.2008 *“Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”*, ku parashikohet shprehimisht se *“Autoritetet kontraktore, në përcaktimin e grafikëve dhe afateve për përfundimin e punimeve të ndërtimit, në dokumentet e tenderit të prokurimit dhe në kontratën e zbatimit të veprave publike, ndërtimore, detyrohen të llogarisin kryerjen e punimeve, për periudhën 22 mars – 23 tetor me 2(dy) turne, për ndërtimin e objekteve në lartësi, dhe me 3(tri) turne, për ndërtimin e rrugëve dhe ndërtimeve të tjera. ç) Autoritetet kontraktore për moszbatimin e kërkesave të përcaktuara në shkronjën “c” dhe për mosndjekjen e zbatimit e këtyre kushteve (kryerjen e punimeve me dy e tri turne), të përcaktuara në kontratën e nënshkruar, ngarkohen me përgjegjësi administrative dhe/ose me përgjegjësi, sipas legjislacionit për prokurimin publik”*

Gjithashtu në nenin 78 pika 1 dhe 4 të Kodit të Punës parashikohet se: *Kohëzgjatja ditore normale e punës është jo më shumë se 8 orë. Ajo përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, në kontratën kolektive, ose në kontratën individuale të punës, brenda limiteve të kohës javore maksimale të punës.*

4. Pushimi ditor është të paktën 11 orë pa ndërprerje brenda ditës ose në rast nevojë për dy ditë rresht.

Në nenin 83 të Kodit të Punës parashikohet se: *“Kohëzgjatja normale e javës së punës është jo më shumë se 40 orë. Ajo përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, në kontratën kolektive ose në kontratën individuale të punës.”*

Në nenin 85 të Kodit të Punës parashikohet se: *1. Pushimi javor është jo më pak se 36 orë, prej të cilave 24 orë pa ndërprerje. 2. Pushimi javor përfshin ditën e diel. 3. Pushimi javor nuk është i pagueshëm. 4. Përjashtimet rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave ose me kontratë kolektive.*

III.4.6. Pasur parasysh dispozitat ligjore të parashikuara sa më sipër KPP gjykon se referuar vlerës së kontratës, preventivit të punimeve volumit të punimeve që do të kryhen në gjatësinë e rrugës, rëndësisë së veprës, natyrës së punimeve, është e nevojshme që operatorët ekonomikë të disponojnë stafin e nevojshëm në rastin konkret të konsiderueshëm për realizimin me sukses të kontratës. KPP gjykon se përcaktimi i numrit të punonjësve duhet të vijë pas një analize të hollëishme të gjithë elementëve të procedurës si volumi, natyra, grafiku i punimeve, afati i kontratës dhe mundësisë së mobilizimit të punonjësve në orare të caktuara sikundër parashikojnë dispozitat ligjore në fuqi.

Në këtë kuptim pasur parasysh të gjithë elementët e cituar më sipër si dhe mundësinë e kryerjes së punës me tre turne sikundër parashikohet në VKM nr.42 datë 16.01.2008 *“Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi një numër fiks prej 200 punonjësish të përcaktuar në rastin konkret, KPP e vlerëson joproportionale.*

KPP gjykon se për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet disponimi i numrit të nevojshëm të punonjësve nga ana e operatorëve ekonomikë por përcaktimi i numrit duhet të vijë pas një analize gjithëpërfshirëse të gjithë elementëve si më sipërcituar nga autoriteti kontraktor, me qëllim përcaktimin e numrit në mënyrë të arsyeshme, proporcionale, dhe në pëëprthje me nevojat reale për ekzekutimin e kontratës në mënyrë të sukseshme, në respekt të nenit 46 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”* të ndryshuar dhe nenin 26 pika 5 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave *“Për miratimin e rregullave të prokurimit public”* të ndryshuar ku parashikohet se: *“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

Gjithashtu, referuar dokumentacionit të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ, aktit mbi miratimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi si edhe trajtimit ankesës së operatorit ekonomik ankimues, KPP konstaton se autoriteti kontraktor nuk ka arritur të argumentojë teknikisht mbi kërkesën për disponimin e një numri prej 200 punonjësish si dëshmi të fuqisë punëtore.

III.4.7. Në këtë kuptim Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin sa më sipër duke ulur numrin e punonjësve të kërkuar në proporcion me volumin e kontratës,

duke marrë gjithashtu në konsiderate edhe parashikimet e Vendimit nr.42/2008 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” ku përcaktohet detyrimi i kryerjes së punimeve me dy dhe tre tune, si edhe kohëzgjatjen maksimale të kohës së punës, pushimeve ditore, javore dhe vjetore të përcaktuara në Kodin e Punës.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit qëndron.

III.4.8. Ndërsa sa i takon pretendimit të operatorit ekonomik ankimues “Po kështu nisur nga data e zhvillimit të tenderit dhe pagesat e sigurimeve shoqërore që bëhet cdo tre muaj duhet që AK të zhvendosë periudhën kohore për listpagesat (duke mos e zgjatur si periudhë) për të marrë një informacion sa më real në lidhje me kriterin, KPP gjykon se kërkesa e autoritetit kontraktor lidhur me periudhën e kërkuar (Dhjetor 2019 – Maj 2020) e gjen të pabazuar pasi autoriteti kontraktor në hartimin e kriterit i është referuar datës së publikimit të procedurës konkretisht 01.06.2020 duke kërkuar listpagesat e sigurimeve shoqërore deri në Maj 2020. KPP gjykon se autoriteti kontraktor referuar datës së publikimit dhe zhvillimit të tenderit ka gjykuar të mjaftueshme për krijimin e një panorame të plotë dhe bindëse mbi stafin e operatorëve ekonomikë pjesmarrës kërkimin e një dëshmie të fuqisë punëtore për periudhën Dhjetor 2019-Maj 2020. Në këto kushte operatorët ekonomikë pjesmarrës në procedurë do të duhet të plotësojnë këtë kërkesë në mënyrën që është formuluar nga autoriteti kontraktor si një kërkesë e arsyeshme, proporcionale dhe aspak diskriminuese.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Geci” sh.p.k. nuk qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Geci” shpk për modifikimin e kriterit Në pikën 2.3.3 është kërkuar Operatori Ekonomik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, duhet të ketë në Stafit teknik kryesor të inxhinierëve minimalisht,

- 1 (nje) Inxhinier Ndertimi/ profili Strukturist
- 2 (dy) Inxhinier Ndertimi/profili transport;
- 1 (nje) Inxhinier Ndertimi/profili Gjeoteknik;
- 1(nje) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (nje) Inxhinier Mekanik
- 3(tre) Inxhinier Topograf
- 2 (dy) Inxhinier Elektrik
- 1 (nje) Inxhinier Gjeolog
- 1 (nje) Inxhinier mjedisi

Për sejcilin pjestar te stafit teknik te mesiperm duhet te paraqese, Kontrate pune e vlefshme, diplome Libreze pune dhe CV, si dhe te rezultojne te siguruar ne listpagesat e shoqerise per periudhen Dhjetor 2019 – Maj 2020.

Ky kriter është në kundërshtim të hapur me rregullat e prokurimit publik që nuk është në përpjestim me punimet objektet e kësaj kontrate. Kështu edhe pse nuk është ndryshuar asgjë në projekt dhe specifikimet teknike të procedurës së anuluar në procedurën e re është shtuar kriteri për 1 Inxhinier Ndërtimi profili/ Strukturist dhe 1 Inxhinier Ndërtimi profili Gjeoteknik. Bazuar në tipologjinë e kontratës, në zërat e punimeve të përfshira në preventiv si dhe bazuar në stafin e parashikuar në relacionin teknik rezulton se AK nuk ka parashikuar punime për zbatimin e të cilave do të konsiderohej e pamjaftueshme ekspertiza profesionale e 1 Inxhinieri Ndërtimi profili Gjeoteknikë.

Ju bëjmë me dije se në bazë të preventivit për këtë procedurë prokurimi nuk ka asnjë zë punimesh që të korenspondojnë me profilin e inxhinier ndërtimi gjeoteknik. Në preventivin pjesë e dokumentave të tenderit ka punime që realizohen me inxhinier ndërtimi ose gjeolog pa qenë e nevojshme për inxhinier gjeoteknik. Ju sqarojmë se inxhinieria e gjeoteknikës është master 2 vjecar (i cili është futur vitet e fundit te fakulteti i inxhinierisë së ndërtimit) dhe ka në programin e vet këto punime (strukturat mbajtëse të dheut dhe mbrojtëse , të gjitha llojet e themeleve, me pilota, pllakë, tip plint, në tokë dhe në det, tunele , ura diga, laborator, gjeomekanike , përmirësim tunele, ura , diga, laborator , gjeomekanike , përmirësim bazamentesh, metro etj). Po të shikojmë preventivin e hedhur për zbatim nga ana juaj do të konstatojmë që nuk ka asnjë lloj punimesh për inxhinier gjeoteknik prandaj edhe kërkesa e përcaktuar në kriteret e vecanta për kualifikim një inxhinier gjeoteknik , inxhinier ndërtimi profili gjeoteknikë është e paligjshme dhe në kundërshtim me LPP dhe RrPP.

Jo vetëm kaq por edhe detyrimi që ky inxhinier (si dhe të tjerët) të rezultojnë të siguruar në listpagesat e shoqërisë për periudhën Dhjetor 2019-Maj 2020 që ska të bëjë fare me realizimin e një vepre në të ardhmen është kriter që plotësohet vetëm nga fituesi i paracaktuar.

Së fundmi ndryshimi i kriterëve për të njëjtën procedurë pa asnjë arsye nga i njëjti autoritet kontraktor është dyshim i arsyeshëm për shkelje të barazisë në tender”, Komsioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.5.1. Në shtojcën 12 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” pika 2.3.3 “Kapaciteti teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

2.3.3 Operatori Ekonomik për kryerjen e te gjitha punimeve ne objekt, duhet të ketë në Stafit teknik kryesor të inxhinierëve minimalisht,

1 (nje) Inxhinier Ndertimi/ profili Strukturist

2 (dy) Inxhinier Ndertimi/profili transport;

1 (nje) Inxhinier Ndertimi/profili Gjeoteknik;

1(nje) Inxhinier Hidroteknik

1 (nje) Inxhinier Mekanik

3(tre) Inxhinier Topograf

2 (dy) Inxhinier Elektrik

1 (nje) Inxhinier Gjeolog

1 (nje) Inxhinier mjedisi

Për sejcilin pjestar te stafit teknik te mesiperem duhet te paraqese, Kontrate pune e vlefshme, diplome , Libreze pune dhe CV, si dhe te rezultojne te siguruar ne listpagesat e shoqerise per periudhen Dhjetor 2019 – Maj 2020.

III.5.2. Referuar kthim përgjigjes së autoritetit kontraktor drejtuar ankimesit lidhur me kërkesën sa më sipër sqarohet si vijon: *Sa i përket pretendimeve për stafin teknik konkretisht 1 inxhinier ndërtimi/profile strukturist dhe 1 inxhinier ndërtimi/profile gjeoteknik vëmë re se kontestohet kërkesa për ing ndërtimi profile gjeoteknikë. Theksojmë se në këtë tipologji kontrate zërat e punimeve që korensponodojnë me profilin inxhinier ndërtimi /profile gjeoteknik janë: Punimet e dherave dhe prishje ,vendosje gjeotextili dhe gjeogrid, nxjerje uji me pompë, gjeotekstil për vepra arti TYPAR-SF/49, terra armata, macres maccaferri, ngulje dhe shkulje palankolametalike, palankola petalike etj. Duke qenë në një zonë kënetore inxhinieri gjeoteknik merr pjesë në llogaritjen e uljeve dhe kohës së konsolidimit të trupit të rrugës që të konkludohet për fazën e mëtejshme sic mund të jetë vendosja e shtresave pasi cdo ulje jashtë normave të lejuara do të sillte carjen e shtresave.*

Në lidhje me pretendimin për përfshirjen e stafit teknik në listpagesat e shoqërisë jemi të mendimit se nuk është kërkesë e ekzagjuar. Autoriteteti krijon bindjen se stafi i përmbush këto kritere dhe është i gatshëm të përmbushë kontratën menjëherë dhe me efektivitet.

III.5.3. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.” b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; [...*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit... .”

III.5.4. Referuar Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se *“Kontratat për punë publike” janë kontratat publike, që kanë objekt realizimin, projektimin dhe realizimin e punimeve apo të punës ose realizimin me çfarëdo mjeti të një pune, që përputhet me kërkesat e përcaktura nga autoriteti kontraktor.*

III.5.5. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 26, pika 8, parashikohet si më poshtë:
Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratë”.

III.5.6. Kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor harton dokumentat e tenderit, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

III.5.7. Në lidhje me kundërshtimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues, mbi modifikimin e kriterit të veçantë të kualifikimit për një inxhinier ndërtimi me profil gjeoteknik, në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është me vend të ndalet në një test balancues të dy elementëve kryesorë. Së pari, nëse kërkesa në fjalë është e përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti, nëse kërkesa në fjalë shkon përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. Gjithashtu, në shqyrtimin e kriterit të mësipërm të kualifikimit, K.P.P. gjykon të ndalet edhe në faktin nëse kriteri i mësipërm është në proporcion me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 46 pika 1 të LPP-së.

III.5.8. KPP vëren se autoritetit kontraktor në justifikimin për vendosjen e kriterit lidhur me një inxhinier ndërtimi me profil gjeoteknik në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi e ka argumentuar duke ju referuar disa zërave të konsiderueshëm punimesh të parashikuara në preventiv të cilat e bëjnë të nevojshme prezencën e një inxhinieri gjeoteknik

gjatë ekzekutimit të kontratës. Kështu autoriteti kontraktor ju referohet zërave të punimeve si vijon: *Punimet e dherave dhe prishje ,vendosje gjeotextili dhe gjeogrid, nxjerje uji me pompë, gjeotekstil për vepra arti TYPAR-SF/49, terra armata, macres maccaferri, ngulje dhe shkulje palankolametalike, palankola petalike etj. Duke qenë në një zonë kënetore inxhinieri gjeoteknik merr pjesë në llogaritjen e uljeve dhe kohës së konsolidimit të trupit të rrugës që të konkludohet për fazën e mëtejshme sic mund të jetë vendosja e shtresave pasi cdo ulje jashtë normave të lejuara do të sillte carjen e shtresave. KPP gjykon se autoriteti kontraktor e ka argumentuar nevojën për vendosjen e kriterit lidhur me një inxhinier ndërtimi profili gjeoteknik sa kohë në preventivin e punimeve ka zëra që lidhen drejtpërdrejtë me profilin e kërkuar , dhe cka e bën të nevojshme për realizimin me sukses të kontratës. Akoma më tej, KPP gjykon se kërkesa e autoritetit kontraktor për disponimin nga ana e operatorëve ekonomikë të një inxhinieri gjeoteknik është proporcionale me objektin dhe natyrën e kontratës objekt prokurimit, volumin dhe përmasat e kontratës.*

III.5.9. Sa i takon pretendimit të ankimuesit “*Jo vetëm kaq por edhe detyrimi që ky inxhinier (si dhe të tjerët) të rezultojnë të siguruar në listpagesat e shoqërisë për periudhën Dhjetor 2019-Maj 2020 që ska të bëjë fare me realizimin e një vepre në të ardhmen është kriter që plotësohet vetëm nga fituesi i paracaktuar, KPP e gjen të pabazuar pasi autoriteti kontraktor ka kërkuar një periudhë të arsyeshme dhe proporcionale prej 6 muajsh të listpagesave, për provimin nga ana e operatorëve ekonomikë të një stafi të qëndrueshëm i cili është i nevojshëm për realizimin me sukses të kontratës. Kjo është një kërkesë në përputhje me natyrën e kontratës, volumin dhe përmasat e saj dhe aspak diskriminuese.*

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.6. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Geci” shpk për modifikimin e kriterit *Në pikën 2.3.5 është kërkuar Operoret ekonomike duhet te disponojne licensat e nevojshme per zbatimin e kontrates. Per kete duhet te paraqesin licensen perkatese te shoqerise, bazuar ne formatin e miratuar me Vendim te Keshillit te Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, ”Per miratimin e rregullores per kriteret dhe Procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne vepimtari ndertimi”. Shqyrtimi i licensave do te behet mbi bazen e rregullave te parashikuara sa me siper. Licensa profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e puneve te kontrates duhet te permbaje kategorite e meposhtme:*

- NP – 1/D (Punime germimi ne toke.)
- NP – 4/F (Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.)
- NP – 5/C (Punime nentokesore, ura e vepra arti.)
- NP – 7/C (Ujësjiellësa, gazsjellësa, vajsjiellësa, vepra kullimi e vaditje.)
- NP – 11/C (Ndërtime për N/Stacionet, kabinat e transformatoreve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarje e energjisë.)
- NP – 12/C (Punime të inxhinierisë së mjedisit.)
- NS – 6/C (Sinjalistikë rrugore jondriçuese)

- NS – 7/B (Bariera dhe mbrojtje rrugore)
- NS -18/A (Punime topogjeodezike)

Referuar këtij preventivi referues konstatojmë që kategoritë e licencave që duhet të disponojnë operatorët ekonomikë me qëllim kualifikimi janë tërësisht të fryra që tejkalojnë nivelin e punëve të kërkuara për këtë procedurë prokurimi duke pasur në konsideratë fondin limit në dispozicion. Rezulton që nga ana juaj është kërkuar:

- NP – 1/D (Punime germimi ne toke. 101-200 milion lekë
- NP – 4/F (Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale. 401-800 milion lekë
- NP – 5/C (Punime nentokesore, ura e vepra arti. 51-101 milion lekë
- NP – 7/C (Ujësjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje.) 51-100 milion lekë
- NP – 11/C (Ndërtime për N/Stacionet, kabinat e transformatoreve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarje e energjisë.) 51-100 milion lekë
- NP – 12/C (Punime të inxhinierisë së mjedisit.) 51-100 milion lekë
- NS – 6/C (Sinjalistikë rrugore jondriçuese) 51-100 milion lekë
- NS – 7/B (Bariera dhe mbrojtje rrugore) 21-50 milion lekë
- NS -18/A (Punime topogjeodezike) 0-20 milion lekë

Si fillim konstatojmë që në mënyrë të paligjshme pa asnjë argument shtesë, projekt ose specifikim teknik është shtuar kategoria NS-7/B (Bariera dhe mbrojtje rrugore) edhe pse nga vetë AK është pranuar që nuk do të ketë sinjalistikë për këtë objekt në këtë fazë.

Nëse marrim në konsideratë fondin limit të dhënë dhe vlerat minimale të licencave të kërkuara rezulton që tejkalojnë disa herë vlerën e punimeve që kërkohet. Bazuar në informacionin që disponojmë për projekte të tilla dhe Vendimin e KM nr.42 datë 16.01.2008 konstatojmë që shumë nga këto kategori nuk janë në përputhje me të.

NP-7/C (Ujësjellësa, gazësjellësa, vajësjellësa, vepra kullimi e vaditje) 51-100 milion lekë. Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshme për realizimin “e shërbimit hidrik kompleks” ose për transportimin në vendet e përdorimit të gazrave, vajrave dhe veprave lidhëse, plotësuese ose ndihmëse edhe në pika të veçanta si edhe në të gjitha impiantet mekanik të nevojshme për të pasur një shërbim të mirë të nevojshëm gjatë përdorimit, funksionimit, informimit, sigurisë dhe asistencës për një funksionim normal. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar veprat e kaptazhit të ujit, impiantet e trajtimit të ujit të pijshëm, ujësjellësit, kullat e ujit, stacionet e pompimit, depozitat në tokë ose të ngritura, rrjetin shpërndarës deri tek përdoruesi, furnizimi dhe vendosja në vepër e tubacioneve, shkarkimet e ujërave të zeza, si dhe trajtimin e ujërave të përdorura.

Ky kriter nuk ka asnjë bazë ligjore në lidhje me objektin e prokurimit. Referuar preventivit të dhënë për këtë kategori punimesh ka zero punime. Kriteri qëllimisht do të sjellë kufizimin e pjesmarrjes së OE ofertues të mundshëm të cilët vlerësohet se kanë kapacitetin e nevojshëm dhe të mjaftueshme për ekzekutimin e kontratës, AK duhet ti përmbahet edhe përcaktimeve të nenit 20 të LPP për të shmangur cdo kriter apo kërkesë që lidhet me kualifikimin e operatorëve

ekonomikë që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre.

NP-12/C “Punime të inxhinierisë së mjedisit) 51-100 milion lekë Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimet të kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik dhe zoologjik. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar procesin e riaftësimit natyror, botanik, faunistik, konservimin dhe riaftësimin e terrenit të përdorur për karriera e gurore, dhe të baseneve hidrografike, eliminimin e prishjes së ekuilibrave hidrogeologjik nëpërmjet kthimit në toka buke të veprave për stabilizimin e shpateve dhe ripyllëzimeve të punimeve të sistemit bujqësor dhe të veprave për rivegetizimin e skarpateve rrugore, hekurudhor të karriera dhe mbetjeve inerte.

Ky kriter nuk ka asnjë bazë ligjore në lidhje me objektin e prokurimit aq më tepër në nivelin C. Ky kriter nuk ka asnjë bazë ligjore në lidhje me objektin e prokurimit.. Kriteri qëllimisht do të sjellë kufizimin e pjesmarrjes së OE ofertues të mundshëm të cilët vlerësohet se kanë kapacitetin e nevojshëm dhe të mjaftueshme për ekzekutimin e kontratës, AK duhet ti përmbahet edhe përcaktimeve të nenit 20 të LPP për të shmangur cdo kriter apo kërkesë që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre.

NS-6C (Sinjalistikë rrugore jo ndricuese) 51-100 milion lekë Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja, ristrukturimi dhe kryerja e sinjalistikës rrugore jondricuese, vertikale, horizontale dhe komplementare

Ky kriter nuk ka asnjë bazë ligjore në lidhje me objektin e prokurimit aq më tepër në nivelin C. Kriteri qëllimisht do të sjellë kufizimin e pjesmarrjes së OE ofertues të mundshëm të cilët vlerësohet se kanë kapacitetin e nevojshëm dhe të mjaftueshme për ekzekutimin e kontratës, AK duhet ti përmbahet edhe përcaktimeve të nenit 20 të LPP për të shmangur cdo kriter apo kërkesë që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.6.1. Në shtojcën 12 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” pika 2.3.5 “Kapaciteti teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

2.3.5 Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë licensat e nevojshme për zbatimin e kontrates. Per kete duhet te paraqesin licensen perkatese te shoqerise, bazuar ne formatin e miratuar me Vendim te Keshillit te Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, ”Per miratimin e rregullores per kriteret dhe Procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi”. Shqyrtimi i licensave do te behet mbi bazen e rregullave te parashikuara sa me sipër. Licensa profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e puneve te kontrates duhet te permbaje kategorite e meposhtme:

- NP – 1/D (Punime germimi ne toke.)
- NP – 4/F (Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.)
- NP – 5/C (Punime nentokesore, ura e vepra arti.)
- NP – 7/C (Ujësjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje.)
- NP – 11/C (Ndërtime për N/Stacionet, kabinat e transformatoreve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarje e energjisë.)
- NP – 12/C (Punime të inxhinierisë së mjedisit.)
- NS – 6/C (Sinjalistikë rrugore jondriçuese)
- NS – 7/B (Bariera dhe mbrojtje rrugore)
- NS -18/A (Punime topogjeodezike)

III.6.2. Referuar kthim përgjigjes së autoritetit kontraktor drejtuar ankimuesit lidhur me kriterin sa më sipër sqarohet se është:

Për pikat e licencave NS-7/B, NP-7/C dhe NP-12/C kategoritë e vendosura nuk janë në tejkallim të vlerave përkatëse pasi bazohen në preventivin e punimeve, relacionin teknik dhe specififikimet teknike. Kësisoj këto pretendime nuk qëndrojnë.

Ndërsa pika e licencës NS-6/C që ka të bëjë me sinjalistikën rrugore jo ndricuese duke reflektuar mbi pretendimin e ankimuesit dhe në referim të preventivit gjykojmë se duhet të ndryshohet në NS-6/B.

III.6.3. Në nenin 46, pika 1, të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” parashikohet shprehimisht se: *"Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese."*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-se përcakohet se: "Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specififikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit."

III.6.4. Referuar VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 26 “Kontratat për punë publike”, pika 5 përcaktohet: *“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

III.6.5. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 26, pika 8, parashikohet si më poshtë: *Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:*

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratë”

III.6.6. Në Lidhjen 4 “Klasifikimi paraprak i shoqërive ndërtimore sipas niveleve për çdo kategori punimesh zbatimi” të Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” , i ndryshuar, parashikohet:

NIVELI I SHOQËRISË	SIPAS VLERAVE NË LËKË TË PUNIMEVE TE KRYERA PËR CDO KATEGORI PUNIMI
<i>A (edhe për herë të parë)</i>	<i>0-20 milion lekë</i>
<i>B</i>	<i>21-50 milion lekë</i>
<i>C</i>	<i>51-100 milion lekë</i>
<i>D</i>	<i>101-200 milion lekë</i>
<i>E</i>	<i>201-400 milion lekë</i>
<i>F</i>	<i>401-800 milion lekë</i>
<i>G</i>	<i>mbi 800 milion lekë</i>

NS-7/B (Bariera dhe mbrojtje rrugore)

Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja ristrukturimi i elementeve si guard rail, në jersey, zvogëluesit e zhurmave, barrierat në kthesa dhe të ngjashme, të realizuar për të siguruar fluksin e mjeteve rrugore dhe për të mbrojtur rënien në kthesa.

NP-7/C (Ujësjllësa, gazësjllësa, vajësjllësa, vepra kullimi e vaditje) 51-100 milion lekë. Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshme për realizimin “e shërbimit hidrik kompleks” ose për transportimin në vendet e përdorimit të gazrave, vajrave dhe veprave lidhëse, plotësuese ose ndihmëse edhe në pika të veçanta si edhe në të gjitha impiantet mekanik të nevojshme për të pasur një shërbim të mirë të nevojshëm gjatë përdorimit, funksionimit, informimit, sigurisë dhe asistencës për një funksionim normal. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar veprat e kaptazhit të ujit, impiantet e trajtimit të ujit të pijshëm, ujësjllësit, kullat e ujit, stacionet e pompimit, depozitat në tokë ose

të ngritura, rrjetin shpërndarës deri tek përdoruesi, furnizimi dhe vendosja në vepër e tubacioneve, shkarkimet e ujërave të zeza, si dhe trajtimin e ujërave të përdorura.

NP-12/C “Punime të inxhinierisë së mjedisit) 51-100 milion lekë Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimin të kompaktësimin të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitetin botanik dhe zoologjik. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar procesin e riaftësimin natyror, botanik, faunistik, konservimin dhe riaftësimin e terrenit të përdorur për karriera e gurorë, dhe të baseneve hidrografike, eliminimin e prishjes së ekuilibrit hidrogjeologjik nëpërmjet kthimit në toka buke të veprave për stabilizimin e shpatëve dhe ripyllëzimeve të punimeve të sistemit bujqësor dhe të veprave për rivegetizimin e skarpateve rrugore, hekurudhor të karriera dhe mbetjeve inerte.

NS-6C (Sinjalistikë rrugore jo ndriçuese) 51-100 milion lekë Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja, ristrukturimi dhe kryerja e sinjalistikës rrugore jondriçuese, vertikale, horizontale dhe komplementare.

III.6.7. Referuar preventivit të punimeve të kontratës objekt prokurimi rezulton se kategoritë e punimeve të parashikuar në vepër janë si vijon:

Punimet e dherave dhe prishje,

Shtresat rrugore,

Strukturat e vogla (tombinot, mure mbajtëse, kuneta),

Nënkalimi,

Punime sinjalistike dhe ndihmëse,

Zërat shtesë spostim linje elektrike,

III.6.8. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapacitetëve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit zotërojnë kapacitetin teknik e konkretisht licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve.

Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përparësim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Dokumentat e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të

barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin e sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 1 pika 2 të LPP-së

III.6.9. Në lidhje me kundërshtimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues, mbi modifikimin e kriterit të veçantë të kualifikimit, në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është me vend të ndalet në një test balancues të dy elementëve kryesorë. Së pari, nëse kërkesa në fjalë është e përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti, nëse kërkesa në fjalë shkon përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. Gjithashtu, në shqyrtimin e kriterit të mësipërm të kualifikimit, K.P.P. gjykon të ndalet edhe në faktin nëse kriteri i mësipërm është në proporcion *me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet* në zbatim të nenit 46 pika 1 të LPP-së

Në rastin konkret, referuar projekt preventivave dhe relacioneve teknike të procedurës së mësipërme të prokurimit, Komisioni gjykon se kriteri lidhur me kategoritë e licencave të kërkuara është në përputhje me natyrën dhe zërat e punimeve të ndërtimit për objektin që prokurohet pasi objekti i prokurimit është veprimtari e mirëfilltë ndërtimi dhe zërat e kërkuar për realizimin e tij si: *Punimet e dherave dhe prishje, , Shtresat rrugore, , Strukturat e vogla (tombinot, mure mbajtëse, kuneta), Nënkalimi, Punime sinjalistike dhe ndihmëse, Zërat shtesë spostim linje elektrike*, bëjnë të domosdoshme kërkesën që operatorët ekonomikë të interesuar për të marrë pjesë në këtë procedurë, të jenë të pajisur me licencë zbatimi për punime ndërtimi, të lëshuar nga autoritetet kompetente.

III.6.10. Konkretisht kërkesa e autoritetit kontraktor për kategorinë e licencës *NS-7/B (Bariera dhe mbrojtje rrugore)* ku referuar përcaktimeve në VKM nr. 42, datë 16.01.2008 "*Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi*" e ndryshuar, konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja ristrukturimi i elementeve si guard rail, neë jersey, zvogëluesit e zhurmave, barrierat në kthesa dhe të ngjashme, të realizuar për të siguruar fluksin e mjeteve rrugore dhe për të mbrojtur rënien në kthesa" KPP vëren se në seksionin nr.5 "punime sinjalistike dhe ndihmëse të preventivit" rezulton se do të kryhen zëra punimesh si vendosje guardrail H2anësore me 2 valz në një anë W3+akesorë, Guardrail H2 anësorpër urë me 2 valz në një anë W4+ akeseorë. Në këtë kuptim KPP gjykon se kjo kërkesë e autoritetit kontraktor është proporcionale dhe është e nevojshme për realizimin e zërave të preventivit të kontratës objekt ankimi pasi këto zëra përfshihen në përkufizimin për këtë kategori licence.

III.6.11. Gjithashtu kërkesa e autoritetit kontraktor për disponimin nga ana e operatorëve ekonomikë të licencës *NP-7/C (Ujësjllësa, gazësjllësa, vajësjllësa, vepra kullimi e vaditje) 51-100 milion lekë* ku sipas VKM nr. 42, datë 16.01.2008 "*Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi*" e ndryshuar konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshme për

realizimin “e shërbimit hidrik kompleks” ose për transportimin në vendet e përdorimit të gazrave, vajrave dhe veprave lidhëse, plotësuese ose ndihmëse edhe në pika të veçanta si edhe në të gjitha impiantet mekanik të nevojshme për të pasur një shërbim të mirë të nevojshëm gjatë përdorimit, funksionimit, informimit, sigurisë dhe asistencës për një funksionim normal. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar veprat e kaptazhit të ujit, impiantet e trajtimit të ujit të pijshëm, ujësjellësit, kullat e ujit, stacionet e pompimit, depozitat në tokë ose të ngritura, rrjetin shpërndarës deri tek përdoruesi, furnizimi dhe vendosja në vepër e tubacioneve, shkarkimet e ujërave të zeza, si dhe trajtimin e ujërave të përdorura, KPP referuar preventivit të punimeve konstaton parshikohen punime si vendosje tuba PVC për shkarkim ujrash në pjesë rruge me pjerësi njëanësore, nxjerje uji me pompë, cka e bën të nevojshme dhe proporcionale kërkesën për disponim licence NP 7/C nga ana e operatorëve ekonomikë pjesmarrës.

III.6.11. Gjithashtu lidhur me kategorinë e licencës NS-6C (Sinjalistikë rrugore jo ndricuese) 51-100 milion lekë ku sipas VKM 42, datë 16.01.2008 “*Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi*” e ndryshuar konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja, ristrukturimi dhe kryerja e sinjalistikës rrugore jondricuese, vertikale, horizontale dhe komplementare, KPP referuar preventivit të punimeve konstaton një seksion të tërë me titull punime sinjalistike dhe ndihmëse cka e bën të nevojshme disponimin nga ana e operatorë ekonomikë të kësaj kategorie licence.

III.6.12. Lidhur me kategorinë e Licencës NP-12/C “Punime të inxhinierisë së mjedisit) 51-100 milion lekë ku sipas VKM konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimit të kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik dhe zoologjik. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar procesin e riaftësimit natyror, botanik, faunistik, konservimin dhe riaftësimin e terrenit të përdorur për karriera e gurore, dhe të baseneve hidrografike, eliminimin e prishjes së ekuilibrave hidrogeologjik nëpërmjet kthimit në toka buke të veprave për stabilizimin e shpateve dhe ripyllëzimeve të punimeve të sistemimit bujqësor dhe të veprave për rivegjetizimin e skarpateve rrugore, hekurudhor të karrierave dhe mbetjeve inerte. , KPP referuar preventivit të punimeve autoriteti kontraktor ka parashikuar punime të ndryshme si Germim, veshje me bar, veshje e skarpatave me bar në mbushje, tombino etj cka e bën të nevojshëm disponimin nga ana e operatorëve ekonomikë të kësaj kategorie licence. KPP gjykon se referuar, natyrës së punimeve të mësipërme, për këto të fundit, shfaqet e nevojshme disponueshmëria e kategorive të licencës për zbatim NP 12, si punime të cilat përfshihen në grupin e punimeve parashikuar në lidhjen nr.3 të Vendimit nr. 42, datë 16.01.2008 të Këshillit të Ministrave “*Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi*”, i ndryshuar.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimes nuk qëndron.

III.6.13. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues mbi nivelin e klasiifikimit të licencave, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se referuar fondit limit të përlllogaritur nga autoriteti kontraktor për procedurën e mësipërme të prokurimit, evidentohet qartë se niveli i klasiifikimit “C”, për vlerë punimesh 51-100 milion lekë, është brenda vlerës së lejuar për përmbushjen e objektit të kontratës objekt prokurimi. Sa më sipër, KPP gjykon se në përgjigje të testit të proporcionalitetit të mësipërme, kërkimi i autoritetit kontraktor mbi disponueshmërinë e kategorive të licencës sipas klasave si më sipër kërkuar, parë kjo në raport (proporcion) me vlerën dhe natyrën e punimeve, detyrimet që rrjedhin nga akti nënligjor është një kërkesë në përpjestim me natyrën dhe objektin e punimeve dhe nuk shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.6.14. Ndërsa sa i takon pretendimit të pranuar nga ana e autoritetit kontraktor lidhur me ulejen e kategorisë së licencës NS-6/C në NS-6/B, KPP gjykon se autoriteti kontraktor duhet të hartojë shtojcën me ndryshimet përkatëse dhe njëherazi të bëjë publikimin e saj në SPE në përputhje me nenin 42 të LPP i cili parashikon shprehimisht se: *Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]* Autoriteti kontraktor, në çdo kohë, përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë për sqarim nga një operator ekonomik, mund të bëjë ndryshime në dokumentet e tenderit, përmes hartimit të një shtojce. Çdo shtojcë u komunikohet menjëherë të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit dhe bëhet detyruese për ta. Shtojca vihet në dispozicion edhe në rrugë elektronike.

III.7. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Geci” shpk për modifikimin e kriterit “Në pikën 2.3.6 është kërkuar: Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar si pjese te stafit 1 (nje) ekspert i pajisur me “Licence zbatimi per veprimtari Arkeologjike” (Me qellim qe te monitorohen punimet per te mos patur pasoja te mundshme ne Arkeologji, shohim te arsyeshme qe ne perberje te stafit te jete edhe eksperti i mesiperm). Te paraqese, Kontrate pune e vlefshme, diplome , Libreze pune dhe CV, si dhe te rezultojne te siguruar ne listpagesat e shoqerise per te pakten 6 (gjashte) muajt e fundit.

Ky kriter është vënë në kundërshtim të hapur me rregullat e prokurimit publik , nuk është në përpjestim me punimet objekt i kësaj kontrate. Kështu edhe pse nuk është ndryshuar asgjë në projekt dhe speciifikimet teknike të procedurës së anuluar në procedurën e re është shtuar kriteri Licence zbatimi per veprimtari Arkeologjike”.

Sipas VKM përkatëse “Cdo individ apo person juridik që kërkon të ushtrojë veprimtari në fushën e arkeologjisë duhet të pajisjet me licencë profesionale përkatëse bazuar në kushtet e parashikuara në këtë vendim. Nuk e kuptojmë nëse AK në këtë rast po kërkon për thesare apo

po ndërton një rrugë në gjurmën ekzistuese të saj . Jo vetëm kaq por kërkohet që të jetë pjesë e OE duke qenë i siguriar 6 muaj përpara zhvillimit të tenderit. Kuptohet qartë që është kriter që e ka vetëm subjekti i paracaltuar fitues nga ana juaj.

Në studimin që iu bë nga ana jonë dokumentacionit të paraqitur por edhe vendodhjes së objektit konstatojmë që:

Objekti nuk është në zonën e mbrojtur

Është rrugë ekzistuese

Në të gjitha specifikimet teknike nuk gjen asnjë fjalë të vetme që të trajtojë arkeologjinë.

Në informacionin e publikuar nga AK thuhet shprehimisht “Projekti shtrihet në zonën ish kënetë të Durrësit dhe shërben kryesisht si rrugë për zhvillimet dhe planifikimet në fushën e indistrisë së naftës. Projekti shtrihet në një zonë ku momentalisht ka mjaft probleme mjedisore me ndotjen dhe depozitimin e plehrave të cilat kanë kontaminuar të gjithë zonën dhe përbëjnë shqetësim real për banorët dhe biznesin.

Ky kriter nuk ka asnjë bazë ligjore në lidhje me objektin e prokurimit dhe qëllimisht do të sjellë kufizimin e pjesmarrjes së OE ofertues të mundshëm të cilët vlerësohet se kanë kapacitetin e nevojshëm dhe të mjaftueshme për ekzekutimin e kontratës, AK duhet ti përmbahet edhe përcaktimeve të nenit 20 të LPP për të shmangur cdo kriter apo kërkesë që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.7.1. Në shtojcën 12 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” pika 2.3.6 “Kapaciteti teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

- *Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar si pjese te stafit 1 (nje) ekspert i pajisur me “Licence zbatimi per veprimtari Arkeologjike” (Me qellim qe te monitorohen punimet per te mos patur pasoja te mundshme ne Arkeologji, shohim te arsyeshme qe ne perberje te stafit te jete edhe eksperti i mesiperme). Te paraqese, Kontrate pune e vlefshme, diplome , Libreze pune dhe CV, si dhe te rezultojne te siguruar ne listpagesat e shoqerise per te pakten 6 (gjashte) muajt e fundit.*

III.7.2. Në nenin 46, pika 1, të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” parashikohet shprehimisht se: *"Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese."*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-se përcakohet se: *"Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit."*

III.7.3. Referuar VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 26 “Kontratat për punë publike”, pika 5 përcaktohet: *“Kërkesat e veçanta të*

kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.7.4. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 26, pika 8, parashikohet si më poshtë:
Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratë”

III.7.5. Në nenin 144 të Ligjit 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” parashikohet shprehimisht se:

Janë gjetje rastësore, si pasojë e punimeve apo të një fakti çfarëdo, dalja në dritë e monumenteve, rrënojave, strukturave, mozaikëve, thesareve, elementeve të kanalizimeve antike, mesjetare, gjurmëve të banimit apo varrezave antike, mbishkrimeve, apo, në mënyrë më të përgjithshme, të gjitha objektet që përbëjnë interes për parahistorinë, historinë, artin, arkeologjinë dhe etnografinë. 2. Gjetjet rastësore janë të luajtshme dhe të paluajtshme.

Ndërsa në nenin 145 të ligjit të sipërcituar parashikohet se:

Ecuria e zbatimit të projektit zhvillimor, e miratuar nga KKTKM-ja, mbikëqyret nga institucionet e specializuara dhe monitorohet nga subjektet e licencuara ose nga specialistët e fushës, sipas listës së krijuar e të përditësuar nga IKTK-ja.

2. Nëse, gjatë punimeve, ndeshen gjetje rastësore, sipas përcaktimit të pikës 1, të nenit 144, të këtij ligji, punimet ndërpriten menjëherë.

3. Drejtuesi teknik ose investitori deklarojnë me shkrim, brenda tri ditëve, tek organet e vetëqeverisjes vendore dhe drejtoritë rajonale të trashëgimisë kulturore për gjetjen rastësore.

4. DRTK-ja, menjëherë, bën verifikimet e nevojshme në terren dhe ia përcjell ato zyrtarisht IKTK-së. 5. IKTK-ja, nëpërmjet strukturave të veta dhe në bashkëpunim me DRTK-në dhe me persona juridikë e fizikë, të licencuar në këtë fushë, ose persona të listuar në listën e monitoruesve të arkeologjisë, bën ndjekjen e gjetjeve rastësore arkeologjike dhe merr masa për shpëtimin e këtyre vlerave.

6. Në rastet e zbulimeve të rëndësishme, punonjësi i autorizuar nga IKTK-ja ose subjekti i licencuar apo monitoruesi, urdhëron pezullimin e punimeve që mund të dëmtojnë vlerat arkeologjike deri në marrjen e një vendimi nga KKTKM-ja. Punonjësi i autorizuar, brenda 5

ditëve nga pezullimi i punimeve, dërgon pranë KKTKM-së relacion mbi gjetjen dhe rëndësinë arkeologjike të tyre. KKTKM -ja shprehet me vendim brenda 10 ditëve.

III.7.6. Referuar kthim përgjigjes së autoritetit kontraktor drejtuar ankimuesit lidhur me pretendimin sa më sipër argumentohet se: *Qyteti i Durrësit është një zonë e pasur arkeologjike. Vecanërisht periferia e qytetit është e rrethuar me stacion prehistorik , tempuj arkaik, banesa e varreza antike e mure romake, si dhe gjurmë të periudhës veneciane. Sa i përket përfshirjes në listpagesa jemi të mendimit se me qëllim që të monitorohen punimet për të mos pasur pasojë të mundshme në Arkeologji shohim të arsyeshme që në përbërje të stafit të jetë edhe eksperti i mësipërm kërkesë që gjithashtu është në linjë me gjitha profesionet e tjera të kërkuara për të cilët është kërkuar periudha 6 mujore listpagesa.*

III.7.7. Referuar bazës ligjore të sipërcituar dhe argumentave të sjella nga autoriteti kontraktor, KPP konstaton se autoriteti kontraktor në vendosjen e kriterit të vecantë të kualifikimit ka marrë parasysh faktin se qyteti i Durrësit është një zonë e pasur arkeologjike dhe në zonën në të cilën do të kryhen punime mund të ketë elementë arkeologjikë që mund të zbulohen gjatë ndërtimit të veprës. Për këtë arsye autoriteti kontraktor ka gjykuar të nevojshme kërkesën për disponimin nga ana e operatorëve ekonomikë të një eksperti të pajisur me licencë zbatimi për veprimtari arkeologjike në mënyrë që të vlerësojë rast pas rasti dhe të mbrojë çdo element me vlerë sado pak historike që mund të çenohet gjatë kryerjes së punimeve për ndërtimin e rrugës.

Akoma më tej, KPP nga verifikimi në faqen zyrtare të Ministrisë së Kulturës dhe Turizimit konstatoi listën e objekteve zonë e mbrojtur në qarkun e Durrësit. Në këtë listë rezulton të jenë klasifikuar si zonë e mbrojtur edhe Muret e Portës Porto Romano. Referuar hartave dhe relacioneve teknike të autoritetit kontraktor, KPP vëren se gjurma në të cilën do të realizohet objekti i prokurimit është në kufij të mureve të Porto Romanos të kategorizuar si zonë e mbrojtur.

Sa më sipër KPP gjykon se kërkesa e autoritetit kontraktor është e arsyeshme, jo diskriminuese dhe ka lidhje me objektin e prokurimit pasi ajo i shërben qëllimit për ruajtjen e vlerave historike të cilat mund të preken gjatë zbatimit të punimeve e vecanërisht gërmimeve.

KPP gjykon se interesi publik në rastin konkret që jo vetëm të ndërtohet në rrugë me të gjitha parametrat e parashikuara por njeherazi të mbrojë vlerat historike/arkeologjike të vendit ku do të ndërtohet e bën kërkesën e autoritetit kontraktor një kërkesë proporcionale, jodiskriminuese pasur parasysh këtu edhe vlerën dhe përmasat e kontratës objekt prokurimi.

KPP gjykon kërkesa e mësipërme është në përputhje me natyrën e kontratës dhe operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë se disponojnë të gjitha kapacitetet profesionale të kërkuara në mënyrë që të krijojnë bindjen e autoritetit kontraktor për realizimin me sukses të kontratës.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik nuk qëndron.

III.8. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Geci” shpk për modifikimin e kriterit Në pikën 2.3.7 është kërkuar: *Operatori ekonomik duhet te disponoje dhe paraqese leje dhe licensa si me poshte:*

License për grumbullimin dhe transportimin, e mbetjeve urbane qe kane ndikim ne mjedis, Kodi III.2.B të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit

Licence III.2.A (1+2) - Veprimtarite e Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis

Licence III.1.A tipi C - “Per trajtimin/magazinimin e mbetjeve te tjera te ujrave te zeza urbane, duke perfshire llumin nga ujrat e ndotura urbane, llumin e çisternave septike, mbetjet e ujrave te zeza nga gropa te hapura, mbetje nga pastrami I kanaleve te ujrave te zeza”

Së pari në vendosjen e kriterit për disponimin e licencës Kodi III.2.A (1+2) AK në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik dhe ligjit rregullues nuk ka zbatuar detyrimet e përcaktimeve të nenit 46 të LPP ku përcakton se cdo kriter i vecantë duhet të jetë në përputhje dhe i lidhur ngushtë me natyrën e kontratës e për rrjedhim kërkesa për licensat e sipërcituara duhet të përkojë me tipologjinë e objektit të kontratës që prokurohet.

Po kështu në kuptimin e përcaktimit të pikës a të nenit 1 të Ligjit nr.10440 datë 07.07.2011 Për vlerësimin e ndikimit në mjedis sipas së cilës qëllimi i këtij ligji është të sigurojë një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit përmes parandalimit, minimizimit dhe kompesimit të dëmeve në mjedis nga projektet të propozuara që përpara miratimit të tyre për zhvillim për rrjedhim shërbimet e ekspertizës në fjalë janë realizuar në fazën e studimit dhe projektimit të objekteve ndërtimore.

Rezulton që ekspertizat profesionale në fjalë janë ezauruar në procesin e studimit dhe projektimit nëpërmjet hartimit të preventivit specifikimeve teknike, projektit, relacioneve teknike respektive.

Për rrjedhojë të sa më lart argumentohet që kërkesa në fjalë do të sjellë kufizimin e pjesmarrjes së OE ofertues të mundshëm të cilët konsiderohen që disponojnë kapacitetet e nevojshme dhe të mjaftueshme për zbatimin e kontratës. Në këtë mënyrë janë cënuar parashikimet e nenit 20 të LPP që cdo kërkesë apo kriter që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre ose paracaktim të fituesve.

Së dyti Licencë III.1.A tipi C Per trajtimin/magazinimin e mbetjeve te tjera te ujrave te zeza urbane, duke perfshire llumin nga ujrat e ndotura urbane, llumin e çisternave septike, mbetjet e ujrave te zeza nga gropa te hapura, mbetje nga pastrami I kanaleve te ujrave te zeza”

Ky kriter është vënë në kundërshtim të hapur me rregullat e prokurimit publik , nuk është në përputhje dhe me punimet objekt i kësaj kontrate. Kështu edhe pse nuk është ndryshuar asgjë në projekt dhe specifikimet teknike të procedurës së anuluar në procedurën e re është shtuar kriteri i mësipërm i cili nuk ka lidhje me realizimin e objektit të kontratës.

Referuar projektit , specifikimeve teknike, dhe zërave të preventivit nuk rezulton asnjë detaj i kontratës që lidhet me trajtimin, magazinimin e mbetjeve të tjera të ujrave të zeza urbane duke përfshirë llumin dhe ujrat e ndotura urbane , llumin e çisternave septike, mbetjet e ujrave te

zeza nga gropa te hapura, mbetje nga pastrami i kanaleve te ujrave te zeza. AK qëllimisht ka ngatëruar ndërtimin e rrugës me pastrimin e gropave septike por është akoma më e rëndë kur nga ana tjetër kërkohet arkeolog.

Autoriteti kontraktor nuk mund të kërkojë leje mjedisore për cdo zë të preventivit (edhe pse nuk ka të tillë) të shërbimeve që kërkohen të realizohen por duhet të përcaktojë kriterin duke u bazuar në objektin e përgjithshëm të prokurimit. Për sa kohë që objekti i procedurës së mësipërme të prokurimit është pastrimi, grumbullimi dhe largimi i mbeturinave rrjedhimisht dhe kërkesa për leje mjedisore duhet të hartohet në përputhje me këtë objekt. Shkelje të tilla me dashje nuk janë vetëm shkelje administrative por penale që në rast mosrefektimi nga ana juaj do të përgjigjeni”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.8.1. Në shtojcën 12 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” pika 2.3.7 “Kapaciteti teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

- *Operatori ekonomik duhet te disponoje dhe paraqese leje dhe licensa si me poshte:*
- *License për grumbullimin dhe transportimin, e mbetjeve urbane qe kane ndikim ne mjedis, Kodi III.2.B të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit.*
- *Licence III.2.A (1+2) - Veprimtarite e Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis*
- *Licence III.1.A tipi C - “Per trajtimin/magazinimin e mbetjeve te tjera te ujrave te zeza urbane, duke perfshire llumin nga ujrat e ndotura urbane, llumin e çisternave septike, mbetjet e ujrave te zeza nga gropa te hapura, mbetje nga pastrami I kanaleve te ujrave te zeza”*

III.8.2. Në nenin 46, pika 1, të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”* b) aftësia teknike: *operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; [...]*”

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-se përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.”*

III.8.3. Referuar VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 26 “Kontratat për punë publike”, pika 5 përcaktohet: *“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe*

vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.8.4. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 26, pika 8, parashikohet si më poshtë:

Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratë”

III.8.5. Referuar kthim përgjigjes së autoritetit kontraktor drejtuar ankimuesit lidhur me kriteret sa më sipër argumentohet si vijon: *Theksojmë se në lidhje me paraqitjen e licencës III.2.A (1+2) gjykojmë se bazuar në nenin 46 të LPP dhe ligjin Nr.104440 datë 07.07.2011 Për vlerësimin e ndikimit në mjedis i ndryshuar autoriteti kontraktor nuk ka gabuar dhe për këtë pikë pretendimi nuk qëndron. Këtë gjë e përforcon edhe qëndrimi i KPP si organi më i lartë në shqyrtimin e ankesave të OE i cili në një vendim të tij shprehet se, KPP vlerëson se kërkesa e autoritetit kontraktor se subjekti njëherazi duhet të jetë i licensuar për vlerësimin e ndikimit në mjedis në përputhje me detyrimet ligjore që rrjedhin nga ky i fundit për raportimin pranë autoritetit kontraktor është një kriter në përputhje me natyrën dhe volumin e procedurës së prokurimit objekt ankimi , nuk tejkalon qëllimin e autoritetit kontraktor dhe nuk shfaq diskriminim të ofertuesve.*

Ndërsa sa i përket pretendimit për disponimin e Licencës III.1.A tipi C gjykojmë se pretendimi i ankimuesit qëndron dhe duhet të merret parasysh.

III.8.6. Në nenin 25 të ligjit nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, parashikohet: “1. Vlerësimi i ndikimit në mjedis i një projekti të propozuar zhvillimi është vlerësimi i ndikimeve të rëndësishme, të mundshme, të asaj veprimtarie në mjedis. 2. Gjatë vlerësimit të ndikimit në mjedis kryhen identifikimi, përshkrimi dhe vlerësimi në mënyrën e duhur i ndikimit në mjedis të një veprimtarie, të referuar në pikën 1 të këtij neni, duke përcaktuar efektet e mundshme të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta mbi tokën, ujin, detin, ajrin, pyjet, klimën, shëndetin e njeriut, florën dhe faunën, peizazhin natyror, pasuritë materiale, trashëgiminë kulturore, duke pasur parasysh lidhjet e tyre të ndërsjella. 3. Vlerësimi i ndikimit në mjedis zbaton parimin e parandalimit që në fazën e hershme të planifikimit të projektit, me qëllim shmangien apo minimizimin e efekteve negative në mjedis, përmes harmonizimit dhe përshtatjes së saj me kapacitetin bartës të mjedisit. 4. Vlerësimi i ndikimit në mjedis kryhet nga zhvilluesi, si pjesë e përgatitjeve për planifikimin e një projekti zhvillimi dhe para kërimit të lejeve përkatëse të zhvillimit. 5. Kërkesat e hollësishme për zbatimin e këtij neni përcaktohen në ligjin për vlerësimin e ndikimit në mjedis.”

III.8.7. Në nenin 20 pika 4 e ligjit nr.10440 datë 7.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, i ndryshuar, parashikohet se: *“Zhvilluesi, gjatë fazës së zbatimit të projektit, i raporton ministrisë për masat e marra për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet negative të veprimtarisë*

III.8.8. Nga interpretimi literal i dispozitave ligjore të sipërcituara, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se vlerësimi i ndikimit në mjedis kryhet nga persona fizik të cilët pajisen me certifikatën përkatëse nga ministria për hartimin e raportit të VNM-së, ekspertizën mjedisore dhe auditimin mjedisor. Gjithashtu, konstatohet se aplikimi pranë Qendrës Kombëtare të Licensimit për vlerësimin e ndikimit në mjedis realizohet që në fazën e hershme të planifikimit të projektit nga zhvilluesi i saj përpara aplikimit pranë autoriteteve përkatëse për lejen e zhvillimit.

KPP vlerëson të sqarojë se referuar kriterëve të veçanta të kualifikimit, preventivit të punimeve dhe natyrës së punimeve, autoriteti kontraktor në asnjë rast nuk ka parashikuar nga ana e operatorit ekonomik fitues i kontratës së procedurës së prokurimit objekt ankimi hartimin e raportit paraprak apo raportit të thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, por nga ana tjetër, në respekt të nenit 20 pika 4 ligjit nr.10440 datë 7.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, i ndryshuar, *“Zhvilluesi, gjatë fazës së zbatimit të projektit, i raporton ministrisë për masat e marra për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet negative të veprimtarisë.”* Në nenin 20 pika 4 e ligjit nr.10440 datë 7.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, i ndryshuar, parashikohet se: *“Projekt” është:* a) zbatim i punimeve të ndërtimit apo instalimeve ose skemave të tjera; b) ndërhyrje të tjera në mjedisin dhe peizazhin natyror, përfshirë edhe ndërhyrjet që kanë të bëjnë me nxjerrjen e mineraleve, duke përfshirë njëherazi edhe projektin e procedurës së prokurimit objekt ankimi.

KPP gjykon se operatori ekonomik fitues i kontratës së prokurimit objekt ankimi në cilësinë e zbatuesit të punimeve dhe në respekt të parashikimeve që rrjedhin nga neni 20 pika 4 i ligjit nr.10440 datë 7.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, i ndryshuar dhe aktit nënligjor në zbatim të ligjit duhet të raportojë pranë autoritetit kontraktor në cilësinë e zhvilluesit të punimeve, për masat e marra për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet negative të veprimtarisë. Sa më sipër, KPP vlerëson se kërkesa e autoritetit kontraktor se subjekti njëherazi duhet të jetë i licencuar për vlerësimin e ndikimit në mjedis në përputhje me detyrimet ligjore që rrjedhin nga ky i fundit për raportimin pranë autoritetit kontraktor është një kriter në përputhje me natyrën dhe volumin e procedurës së prokurimit objekt ankimi, nuk tejkalon qëllimin e autoritetit kontraktor dhe nuk shfaq diskriminim mes ofertuesve.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.8.9. Ndërsa lidhur me kriterin Licencë III.1.A tipi C për të cilën autoriteti ka gjykuar se pretendimi i ankimuesit qëndron dhe duhet të merret parasysh, KPP nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike konstaton se autoriteti kontraktor nuk ka publikuar shtojcën me modifikimet përkatëse. Në këtë kuptim KPP gjykon se autoriteti kontraktor duhet të hartojë shtojcën me ndryshimet përkatëse dhe njëherazi të bëjë publikimin e saj në SPE në përputhje me nenin 42 të LPP i cili parashikon shprehimisht se: *Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave.*

Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”Autoriteti kontraktor, në çdo kohë, përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë për sqarim nga një operator ekonomik, mund të bëjë ndryshime në dokumentet e tenderit, përmes hartimit të një shtojce. Çdo shtojcë u komunikohet menjëherë të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit dhe bëhet detyruese për ta. Shtojca vihet në dispozicion edhe në rrugë elektronike.

III.9. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes “Geci” shpk për modifikimin e kriterit *Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesë deshmi për mjetet dhe paisjet teknike që kanë në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik.*

Kerkohen të jene ne dispozicion keto mjete pune:

Nr	Emri i mjetit	Njesi	Sasi	Statusi
1	Kamiona vetshkarkues min 20 ton	Copë	25	Në pronësi ose me qera
2	Kamiona vetshkarkues 10 deri 18 ton	Copë	4	Në pronësi ose me qera
3	Kamioncine deri 4.5 ton	Copë	6	Në pronësi ose me qera
4	Ekskavatorë me zinxhire	Copë	8	Në pronësi ose me qera
5	Ekskavatorë me goma	Copë	4	Në pronësi ose me qera
6	Ekskavator me krahe te gjate mbi 15 m	Copë	1	Në pronësi ose me qera
7	Fadrome me goma	Copë	3	Në pronësi ose me qera
8	Minieskavatore	Copë	6	Në pronësi ose me qera
9	Çekiç për Eskavator	Copë	2	Në pronësi ose me qera
10	Autobot Uji	Copë	4	Në pronësi ose me qera
11	Buldozer (traktor) ≥ 80 HP	Copë	2	Në pronësi ose me qera
12	Autobetoniere	Copë	3	Në pronësi ose me qera
13	Autobitumatrice	Copë	1	Në pronësi ose me qera
14	Greider	Copë	2	Në pronësi ose me qera

15	Asfalto shtruese	Copë	2	Në pronësi ose me qera
16	Rrul me vibrim gome cylinder mbi 18 ton	Copë	2	Në pronësi ose me qera
17	Rrul cilindër – cilindër der 13 ton asfalti	Copë	2	Në pronësi ose me qera
18	Rul gome cilindër 15 ton	Copë	1	Në pronësi ose me qera
19	Rrul vibrus deri në 8 ton	Copë	4	Në pronësi ose me qera
20	Autovinç	Copë	2	Në pronësi ose me qera
21	Minifadrom	Copë	2	Në pronësi ose me qera
22	Depozitë Uji	Copë	2	Në pronësi ose me qera
23	Pompe uji	Copë	4	Në pronësi ose me qera
24	Sistem Ëell Point për heqjen e ujërave	Copë	4	Në pronësi ose me qera
25	Gjenerator	Copë	5	Në pronësi ose me qera
26	Batipal	Copë	1	Në pronësi ose me qera
27	Hydromulcher, me kapacitet minimum 4 ton	Copë	1	Në pronësi ose me qera
28	Makinë vijezimi	Copë	1	Në pronësi ose me qera
29	Vinç me kapacitet minimumi 20 ton	Copë	1	Në pronësi ose me qera
30	Vibrator	Copë	6	Në pronësi ose me qera
31	Nyje inerte e paisur leje mjedisore kodi III.1.B	Copë	1	Në pronësi ose me qera ose kontratë furnizimi
32	Fabrikë asfalti e paisur leje mjedisore kodi III.1.B	Copë	1	Në pronësi ose me qera ose kontratë furnizimi
33	Fabrikë prodhim betoni e paisur leje mjedisore kodi III.1.B	Copë	1	Në pronësi ose me qera ose kontratë furnizimi
34	Sonde (turjele) për shtyllat e betonit Ø 400mm	Copë	1	Në pronësi ose me qera
35	Tërheqës + gjysmë rimorkio	Copë	4	Në pronësi ose me qera

Së pari edhe pse nuk është ndryshuar asgjë në projekt dhe specifikimet teknike të procedurës së anuluar në procedurën e re janë shtuar kriteret për disponimin e kapaciteteve:

Ekskavator me krahe të gjata mbi 15 m 1 copë
--

<i>Buldozer (traktor) ≥ 80 HP 2 copë</i>
<i>Autobetoniere 1 copë</i>
<i>Rrul cilindër – cilindër der 13 ton asfalti copë 2</i>
<i>Sistem Ëell Point per heqjen e ujrave 4 copë</i>
<i>Gjenerator 3 copë</i>
<i>Hydromulcher, me kapacitet minimum 4 ton 1 copë</i>
<i>Vinç me kapacitet minimumi 20 ton 1 copë</i>
<i>Sonde (turjele) per shtyllat e betonit Ø 400mm 1 copë</i>
<i>Tërheqës + gjysmë rimorkio</i>

Ndërkohë janë hequr kriteret për disponimin e kapaciteteve

Rrul me goma asfalti mbi 25 ton copë

Motobetoniere 2 copë

Autobitumatrice 2 copë Greider 2 copë

Asfaltoshtruese 2 copë

Eskavatorë me goma 2 copë.

Së dyti referuar kriterëve të vecanta për kualifikim konstatohet se ndër të tjera autoriteti kontraktor ka parashikuar një listë të mjeteve dhe të pasjisjeve të cilat janë të nevojshme për realizimin e synimit parësor të autoritetit kontraktor të përmbushjes me sukses të kontratës objekt prokurimi. Ky qëllim i ligjit është shkelur tërësisht kur me një të hedhur të syrit konstatohet që kriteret ndryshohen sipas dëshirës së zyrtarëve të ngarkuar me qëllim zbatimin e tij. Për çfarë duhet një eskavator me krahë të gjatë mbi 15 m që në procedurën e parë nuk qe e nevojshme?? Po kapaciteti Vinc me kapacitet minimumi 20 ton çfarë duhet të ngrejë ndërkohë që nuk ka asnjë peshë të tillë referuar preventivit të dhënë??? Po një rul cilindër cilëindër der 13 ton asfalti kur më parë ishte rrul cilindër cilindër 10-12 ton asfalti?? Çfarë e bëri njësinë e prokurimit të ndryshojë mendje kaq shpejt???

*Në kundërshtim me ligjin dhe RRPP rezulton që janë përcaktuar kamionet e tonazheve Kamiona vetshkarkues min 20 ton; Kamiona vetshkarkues 10-18 ton; kamioncinë deri 4.5 ton pa ansjë bazë ligjore. AK duhet të kërkojë kapacitete mbartëse me qëllim realizimin e kontratës pavarësisht llojit të kamionit duke e kufizuar atë vetëm nëse dëmton rrugën. Por vetë kriteri i dhënë prej 25 kamionësh mbi 20 ton përcalton që nuk ka qenë ky qëllimi. Kapaciteti i kërkuar prej 25*20 t baras 500 t plus 4x15 t baras 60 t plus 4.5x6 baras 27 t në total 587 ton mjete është tejte e ekzagjeruar. Ky kriter nuk ka asnjë bazë ligjore në lidhje me objektin e prokurimit. Kriteri qëllimisht do të sillte kufizimin e pjesmarrjes së OE ofertues të mundshëm të cilët vlerësohen se kanë kapacitetet e nevojshme dhe të mjaftushme për ekezekutimin e kontratës. PO kështu të gjitha kapacitetet në mjete duhet të rishikohen dhe të vihen në përputhje me objektin e kontratës dhe rregullat e prokurimit publik. Nuk mund të përcaktoni fituesin me*

cdo kusht. Jeni të detyruar të zbatoni dispozitat ligjore në fuqi”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.9.1. Në shtojcën 12 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” pika 2.3.13 “Kapaciteti teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

2.3.13 Operatori ekonomik duhet te disponoje mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike per realizimin e kontrates. Per kete duhet te paraqese deshmi per mjetet dhe paisjet teknike qe ka ne dispozicion apo mund t’i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik.

Kerkohen te jene ne dispozicion keto mjete pune:

Nr	Emri i mjetit	Njesi	Sasi	Statusi
1	<i>Kamiona vetshkarkues min 20 ton</i>	<i>Copë</i>	25	<i>Në pronësi ose me qera</i>
2	<i>Kamiona vetshkarkues 10 deri 18 ton</i>	<i>Copë</i>	4	<i>Në pronësi ose me qera</i>
3	<i>Kamioncine deri 4.5 ton</i>	<i>Copë</i>	6	<i>Në pronësi ose me qera</i>
4	<i>Ekskavatorë me zinxhire</i>	<i>Copë</i>	8	<i>Në pronësi ose me qera</i>
5	<i>Ekskavatorë me goma</i>	<i>Copë</i>	4	<i>Në pronësi ose me qera</i>
6	<i>Ekskavator me krahe te gjate mbi 15 m</i>	<i>Copë</i>	1	<i>Në pronësi ose me qera</i>
7	<i>Fadrome me goma</i>	<i>Copë</i>	3	<i>Në pronësi ose me qera</i>
8	<i>Minieskavatore</i>	<i>Copë</i>	6	<i>Në pronësi ose me qera</i>
9	<i>Çekiç për Eskavator</i>	<i>Copë</i>	2	<i>Në pronësi ose me qera</i>
10	<i>Autobot Uji</i>	<i>Copë</i>	4	<i>Në pronësi ose me qera</i>
11	<i>Buldozer (traktor) ≥ 80 HP</i>	<i>Copë</i>	2	<i>Në pronësi ose me qera</i>
12	<i>Autobetoniere</i>	<i>Copë</i>	3	<i>Në pronësi ose me qera</i>
13	<i>Autobitumatrice</i>	<i>Copë</i>	1	<i>Në pronësi ose me qera</i>
14	<i>Greider</i>	<i>Copë</i>	2	<i>Në pronësi ose me qera</i>
15	<i>Asfalto shtruese</i>	<i>Copë</i>	2	<i>Në pronësi ose me qera</i>
16	<i>Rrul me vibrim gome cylinder mbi 18 ton</i>	<i>Copë</i>	2	<i>Në pronësi ose me qera</i>
17	<i>Rrul cilinder – cilinder der 13 ton asfalti</i>	<i>Copë</i>	2	<i>Në pronësi ose me qera</i>

18	Rul gome cilinder 15 ton	Copë	1	Në pronësi ose me qera
19	Rrul vibrus deri ne 8 ton	Copë	4	Në pronësi ose me qera
20	Autovinç	Copë	2	Në pronësi ose me qera
21	Minifadrom	Copë	2	Në pronësi ose me qera
22	Depozitë Uji	Copë	2	Në pronësi ose me qera
23	Pompe uji	Copë	4	Në pronësi ose me qera
24	Sistem Ëell Point per heqjen e ujrave	Copë	4	Në pronësi ose me qera
25	Gjenerator	Copë	5	Në pronësi ose me qera
26	Batipal	Copë	1	Në pronësi ose me qera
27	Hydromulcher, me kapacitet minimum 4 ton	Copë	1	Në pronësi ose me qera
28	Makineri vijezi	Copë	1	Në pronësi ose me qera
29	Vinç me kapacitet minimumi 20 ton	Copë	1	Në pronësi ose me qera
30	Vibrator	Copë	6	Në pronësi ose me qera
31	Nyje inerte e paisur leje mjedisore kodi III.1.B	Copë	1	Në pronësi ose me qera ose kontrate furnizimi
32	Fabrike asafalti e paisur leje mjedisore kodi III.1.B	Copë	1	Në pronësi ose me qera ose kontrate furnizimi
33	Fabrike prodhim betoni e paisur leje mjedisore kodi III.1.B	Copë	1	Në pronësi ose me qera ose kontrate furnizimi
34	Sonde (turjele) per shtyllat e betonit Ø 400mm	Copë	1	Në pronësi ose me qera
35	Tërheqës + gjysmë rimorkio	Copë	4	Në pronësi ose me qera

- Ne rast se mjetet nuk jane ne pronesi apo me qera mund te paraqiten Akt Marrëveshje porosie/Kontratë e Porosie/kontrate leasing/ ose Marreveshje per shitjen me kusht te mjeteve ose cdo forme tjeter kontrate ekuivalente me to e te njohura nga legjislacioni shqiptar . Kontratat apo marreveshjet e sipercituara duhet të jenë lidhur përpara noterit dhe duhet të përmbajnë të dhënat e sakta në lidhje me tipin e mjetit, të dhënat teknike për mjetin, kushtet e kontratës /marrëveshjes si dhe afatin për ekzekutimin e saj
- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur jane ne pronesi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vertetojne pronesine e mjetit:- çertifikaten e pronesise; -leja e

qarkullimit; -çertifikaten e kontrollit teknik; siguracionin ; leja e transportit qe leshohet nga njesia vendore dhe fotot perkatese; ndersa per mjete te marra me qera krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qerese e cila duhet te perfshije objektin perkates dhe duhet te jete e vlefshme per te gjithe periudhen deri ne perfundimin e plote te punimeve.

- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronesi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fotot dhe fatura tatimore perkatese, ndersa per mjete te marra me qera krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qerese e cila duhet te perfshije objektin perkates dhe duhet te jete e vlefshme per te gjithe periudhen deri ne perfundimin e plote te punimeve.
- Për fabriken e asfaltit dhe betonit, nese eshte ne pronesi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fotot dhe fatura tatimore perkatese, leja mjedisore leshuar nga QKL. Nese eshte marre me qera krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qerese. Operatori ekonomik per fabriken e asfaltit dhe betonit mund te paraqese edhe kontrata te vlefshme furnizimi me operatore ekonomike Ne kete rast duhet te paraqese kontraten e furnizimit dhe dokumentacionin qe verteton ekzistencen dhe pronesine e impiantit.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me shkrim për disponueshmërinë e mjeteve gjatë gjithë periudhës së komntrates.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë ku Autoriteti Kontraktor rezervon • të drejtën të kryejë në çdo kohë verifikimin fizik të disponueshmërisë së mjeteve, me apo pa lajmërim paraprak, si dhe te beje deklarimin e adreses se sakte te vendodhjes se mjeteve me qellim verifikimin e tyre”

Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikoje vertetesine e deklarates. Ne rast deklarimi te rreme do te veprohet ne perputhje me nenin 13, pika 3, germa "a" te Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, "Per Prokurimin Publik".

III.9.2. Në nenin 46, pika 1, të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" parashikohet shprehimisht se: "Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese."

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-se përcakohet se: "Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit."

III.9.3. Referuar VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", neni 26 "Kontratat për punë publike", pika 5 përcaktohet: "Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve."

III.9.4. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 26, pika 8, parashikohet si më poshtë:
Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratë”

III.9.5. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik.

III.9.6. Lidhur me pretendimin e ankimuesit se “*Së pari edhe pse nuk është ndryshuar asgjë në projekt dhe specifikimet teknike të procedurës së anuluar në procedurën e re janë shtuar kriteret për disponimin e kapaciteteve: Ekskavator me krahe te gjate mbi 15 m 1 copë Buldozer (traktor) ≥ 80 HP 2 copë Autobetoniere 1 copë Rrul cilindër – cilindër der 13 ton asfalti copë 2 Sistem Ëell Point per heqjen e ujrave 4 copë, Gjenerator 3 copë, Hydromulcher, me kapacitet minimum 4 ton 1 copë, Vinç me kapacitet minimumi 20 ton 1 copë Sonde (turjele) per shtyllat e betonit Ø 400mm 1 copë Tërheqës + gjysmë rimorkio dhe janë hequr disa të tjera” KPP sqaron ankimusin se nuk mund të gjykojë mbi procedura të anuluar por vetëm mbi procedurën e prokurimit objekt ankimi.*

III.9.7. Lidhur me pretendimet e ankimuesit të parashtruara në formën e pyetjeve se *Për cfarë duhet një eskavator me krahe të gjatë mbi 15 m që në procedurën e parë nuk qe e nevojshme?? Po kapaciteti Vinc me kapacitet minimumi 20 ton cfarë duhet të ngrëjë ndërkohë që nuk ka asnjë peshë të tillë referuar preventivit të dhënë???* *Po një rul cilindër cilëindër der 13 ton asfalti kur më parë ishte rrul cilindër cilindër 10-12 ton asfalti?? Sistem Ëell Point për cfarë janë këto sisteme, Hydromulcher, për cfarë kërkohet” Cfarë e bëri njësinë e prokurimit të ndryshojë mendje kaq shpejt??* KPP gjykon se ankimuesi ka parashtruar në formë pyetje dhe jo kundërshtimi konkret në lidhje me këto mjete. Në këto kushte duke qenë se është autoriteti kontraktor organi përgjegjës për hartimin e kriterëve kualifikuese dhe justifikimin për vendosjen e tyre , KPP gjykon se autoriteti kontraktor duhet të sqarojë ankimuesin në mënyë

shtruese mbi nevojën e disponimit të mjeteve sa më sipër. KPP gjykon se autoriteti kontraktor në sqarimin që do japë ankimeusit duhet të justifikojë kërkimin e këtyre mjeteve duke u bazuar në zërat e preventivit dhe në materialet që do të transportohen apo ngrihen rast pas rasti, si edhe duke bërë njëherazi dhe publikimin e sqarimit përkatës në sistemin e prokurimeve elektronike në përputhje me nenin 42 të LPP, i cili, parashikon shprehimisht se: *“Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”*, me qëllim njohjen e të gjithë operatorëve ekonomikë ankimues me sqarimet për dokumentat e tenderit, për të qenë të qarta e të saktë për të gjithë të interesuarit për këtë procedurë prokurimi.

III.9.8. Ndërkohë sa i takon pretendimit të ankimuesit lidhur me *“Në kundërshtim me ligjin dhe RRPP rezulton që janë përcaktuar kamionet e tonazheve Kamiona vetshkarkues min 20 ton; Kamiona vetshkarkues 10-18 ton; kamioncinë deri 4.5 ton pa ansjë bazë ligjore. AK duhet të kërkojë kapacitete mbartëse me qëllim realizimin e kontratës pavarësisht llojit të kamionit duke e kufizuar atë vetëm nëse dëmton rrugën. Por vetë kriteri i dhënë prej 25 kamionësh mbi 20 ton përcakton që nuk ka qenë ky qëllimi. Kapaciteti i kërkuar prej 25*20 t baras 500 t plus 4x15 t baras 60 t plus 4.5x6 baras 27 t në total 587 ton mjete është tejet e ekzagjeruar”*, KPP gjykon se autoriteti kontraktor duhet të sqarojë ofertuesin nëse në përcaktimin e kapacitetet të kamionit i është referuar kapacitetet të mjetit bosh apo atij transportues në mënyrë që kriteri të jetë i qartë dhe i saktë për të gjithë të interesuarit për këtë procedurë prokurimi.

III.9.9. Ndërsa në tërësi, KPP gjykon se pasur parasysh vlerën e kontratës, natyrën e punimeve, volumet e materialeve të cilat janë të një sasi të konsiderueshme, mjetet e kërkuara në rastin konkret kamionët janë të nevojshme për realizimin me sukses të kontratës dhe operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë se disponojnë kapacitetet teknike për ekzekutimin e kontratës,

III.9.10. Lidhur me kërkesën e ankimuesit *“Po kështu të gjitha kapacitetet në mjete duhet të rishikohen dhe të vihen në përputhje me objektin e kontratës dhe rregullat KPP e gjen një kërkesë të pabazuar, të paragumtuar dhe në total, KPP gjykon se në ankesën drejtuar pranë autoritetit kontraktor dhe K.P.P, operatori ekonomik ngre pretendime a-priori për të gjitha specifikimet mjetet duke kërkuar rishikimin e tyre në total. Vlen të ritheksojmë se Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ, i cili në kuptim të nenit 52 të LPP dhe nenit 64 e 65 të VKM nr. 914, datë 29.012.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, shqyrton ankesat mbi vendimet e marra nga KVO e Autoritetit Kontraktor, por ligjvënësi qartazi i ka ndarë detyrat dhe kompetencat e këtyre dy organeve. Pra, KPP nuk mund të marrë tagrin e autoritetit kontraktor (të njësisë së prokurimit në këtë rast) dhe të rivlerësojë në themel të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi. Operatori ekonomik ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar, pra të evidentojë qartë dhe saktë se ku e bazon pretendimin e tij për hartimin e kriterëve dhe specifikimeve teknike në kundërshtim me legjislacionin në fuqi. Është*

barrë e operatorit ekonomik që të përcaktojë se në cilin fakt apo rrethanë e mbështet pretendimin e tij për hartimin e kritereve të dokumentave të tenderit. Në këtë rast, pesha specifike e barrës për të provuar paligjshmërinë hipotetike të këtyre të fundit është e plotë dhe qëndron mbi kurrizin e pretenduesit, ndërkohë që KPP adapton një pozicion re-aktiv, në pritje të argumenteve të plotë provues se përse vendimi i autoritetit kontraktor ka qenë i gabuar, sipas ankimuesit. Një ankim në total, pa argumente të arsyeshme apo indicje të qarta, mbi të gjithë apo shumicën e elementëve përbërës të të dokumentave të tenderit, do të konsiderohet abuziv, në kundërshtim me qëllimin e veprimtarisë së Komisionit, pasi cënon efikasitetin dhe shpejtësinë e procedurës së prokurimit publik dhe nuk do të merret në shqyrtim nga KPP.

KPP është paraparë nga ligji si një quasi gjykatë. Si e tillë në vendimarrjen e tij, Komisioni i Prokurimit Publik zbaton parimet kryesore të së drejtës. Një prej tyre është edhe parimi juridik i cili thekson faktin se gjykata vendos në bazë të akuzave (pretendimeve) dhe provave. Komisioni i Prokurimit Publik refuzon të vendoset në pozitën e avokatit të ankimuesit e të investohet mbi një ankim i cili nuk mbështetet në argumenta konkretë, por vetëm mbi pretendime hipotetike e dyshime të paarsyeshme.

Rrjedhimisht këto pretendime të operatorit ekonomik ankimues nuk merren në shqyrtim.

III.10. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Geci” shpk *Në pikën 2.3.15* Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikatat të vlefshme si me poshte:

- *EN-ISO 14001:2004 (Sistemi i menaxhimit të mjedisit)*
- *EN- ISO 9001-2015 (Sistemi i menaxhimit të cilësive)*
- *EN-OHSAS 18001:2007 (Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë)*
- *ISO 39001:2012 (Sistem i menaxhimit të sigurisë rrugore dhe trafikut)*

Për sa më sipër në lidhje me certifikatën EN OHSAS 18001:2007 duhet që AK të pranojë edhe OE të cilët disponojnë certifikatën me standartin e azhornuar dhe ekuivalent të njohur nga standartet shqiptare ISO 45001:2018.

III.10.1. Referuar kthim përgjigjes së autoritetit kontraktor drejtuar ankimuesit rezulton se kërkesa e mësipërme e ankimeut është pranuar nga autoriteti kontraktor. Lidhur me këtë fakt, KPP nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike konstaton se autoriteti kontraktor nuk ka publikuar shtojcën me modifikimet përkatëse. Në këtë kuptim KPP gjykon se autoriteti kontraktor duhet të hartojë shtojcën me ndryshimet përkatëse dhe njëherazi të bëjë publikimin e saj në SPE në përputhje me nenin 42 të LPP i cili parashikon shprehimisht se: *Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]*”Autoriteti kontraktor, në çdo kohë, përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë për sqarim nga një operator ekonomik, mund të bëjë

ndryshime në dokumentet e tenderit, përmes hartimit të një shtojce. Çdo shtojcë u komunikohet menjëherë të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit dhe bëhet detyruese për ta. Shtojca vihet në dispozicion edhe në rrugë elektronike.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Geci” shpk për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me Nr.REF-59423-05-29-2020 me objekt “Ndertim Rruga Porto Romano Durres, Loti 3”, me fond limit 669.384.858,33 leke pa tvsh, parashikuar për tu zhvilluar në datën 02.07.2020 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.
2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në dokumentat e tenderit sipas konstatimeve të mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Geci” shpk.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Nr. 580 Protokolli, Datë 16.06.2020

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri

